

ROMAN

BIBLIOTEKA

854-31

P 31

RAQ PASKAL

LIQENI I VDEKJES



85H-31

P 31

Raq Paskal

# LIQENI I VDEKJES

Roman



SHTEPI BOTUESE "MENDIMI I LIRE"  
BERAT 2001

Konsulente: Frida Paskal  
Piktor: Raq Paskal

S'mund ta fsheh; një zë dilte mbi të tjerët  
nga turma, e më përkëdhelte shpirtin:  
"Raq Paskali i futi plevitin liqenit, e  
jo liqeni Raq Paskalit".

## Faqe ditari

Ditën e një nëntorit, e fillova me zgjimin në ora pesë. Në ora gjashtë pa çerek, nisa vrapimin bashkë me Arturin. Djali im gjashtëvjeçar është forcuar mjaft. Reziston shumë dhe as që e lodh fare rruga tre kilometra, vajtje-ardhje, për në Liçenin e Viroit. U lamë në ujin e ftohtë, me disa zhytje e kërcime, dhe u fshimë me peshqirët kokërrzorë, në të gjithë trupin. Ky fërkim, ishte njëkohësisht vetmasazh. Muskujt u skuqën nga hiperemia. Kthimin e bëmë me vrap e me ndalesa, me zhonglerime gjylesh në ecje. Dy i mbaja unë dhe një Arturi. Marshimi dhe vrapimi me pesha, është shkallë e lartë përgatitjeje. Në ora shtatë, unë duhej të isha në punë. Zooveterinaria ka patur shumë probleme në ato kohë.

Pasdite, sa kishte dritë diellore, pikturova. Në mbrëmje, rifilluam stërvitjen në palestër. Akrobatëve u kisha dhënë leje të çlodheshin. Gushti ishte muaji i sukseseve të mëdha. Dhamë premierën e cirkut. Kisha aktivizuar tridhjetë e pesë akrobatë. Vetëm tre profesionistë.

Arturi punoi shkëlqyeshëm në peshëngritje. Nga data dy, deri në katërbëdhjetë nëntor, Ditarin nuk e kam plotësuar, nga rutina e përditshme e jetës. Kam shkruar fjalët: I njëjti rregull ditor.

**15. 11. 1968.** Mbrëmë, datë 14 nëntor, Mikeli u sëmur rëndë, me temperaturë 40°C. E hiqte bark, dobësi, iu tha buza, e u bë qull në djersë. Në shtëpi, nuk na u ndodh asgjë për t'i vënë në gojë. Shtëpia ishte bosh. Dollapi i bukës i varfër, vetëm me gjysmë buke gur e fortë dhe gjysmë shishe vaj kikiriku. Një lugë sheqer nuk ndodhej. Të mërzhitur e të tronditur për shëndetin e djalit, dërguam Arturin dhe Djanën, nga Hazmurati, në Palorto, te nëna ime Poli. As ajo nuk kishte gjë për të dhënë.

Arturi shtatë vjeçar, vrapoi sërish në lagjen Meçite, te vjehri im Mehmet Drasa. Ai na dërgoi dy kokrra portokalle, që i këput nga pema, që ka mbjellur vetë në oborr. Edhe pse nuk zhvillohet si në bregdet, kokrrat gjysmë të verdha, gjysmë të gjelbërta, i njomën gojën foshnjës, me lëngun e thartë. I dhamë një aspirinë dhe e mbuluam rëndë. Ai djersiti shumë. Frida i fshinte djersët pandërprerje në kokë, gjoks e shpinë. Temperatura zbriti në 38°C. Frida i bëri roje tërë natën. Kur djali flinte si qengj e u përmirësua, oh sa shumë u lumturuam.

**16. 11. 1968.** Bën ftohtë. Bie shi i imët që të than fytyrën. Më pengon të kryej vrapimin e mëngjesit gjer në Virua. Ndërprerja e gjimnastikës, më jep pasoja: shtimin e peshës, dhjamosjen e zemrës, veshkave, rritjen e barkut dhe vitheve, një deformim të trupit. Gjithë ditën në punë.

Pasdreke pikturova në palestër, por bënte shumë ftohtë. Pa zjarr, në ambjente plot lagështi të mureve, që kullojnë ujëra nga çatia e prishur. E kush çan kokën sot, të meremetojë kishat e xhamitë. E pashë që mu thanë duart, këmbët, trupi i tërë, ndaj fillova stërvitjen me shtangë, bashkë me Arturin.

**17. 11. 1968.** Bëra përpjekje, që cirku të filmohej për televizion. Përgjegjësi i televizionit nuk pranoi, sepse tani për tani, nuk janë të predispozuar. Në mëngjes, operova me sukses qenin e Leonidha Llabros, përgjegjësit të shtypshkronjës. Qeni kishte çarë barkun në gjueti. Në darkë, dhamë cirk në Pallatin e Pionierit.

**18.11.1968.** Mora rrogën e pesëmbëdhjetëditshit, 4300 lekë. Me gjithë kompesimet, 500 lekë. Nga këto: 1000 lekë për këpucët e mia, 1000 lekë blemë patinat e Mikelit, plus mushama, çorape dhe 1000 lekë ushqime. 1000 lekë, ia dhamë mama Polit, se ia kishim borxh. Me kaq, rroga mbaroi që sot.

Pasdreke, në palestër, bëme stërvitje të fortë.

**19.11.1968.** Përgatitje e përgjithshme, lexime, shkrime. Pasdreke, pikturë ordinere në seri, për t'i shitur dhe kompesuar pagat. Në ora katër e gjysmë pasdite, mbarova stërvitjen me akrobatët, në Pallatin e Pionierit.

Sonte në lajme, T.V.SH.-ja më nxori në ekran, duke bërë cirk. Në darkë, unë, Frida, Arturi, shkuam vizitë te prindërit e mi në Palorto. Kisha blerë gjysmë litër raki, dhe një kilogram peshk. Bëmë bisedë të ëmbël. Ishin të gjithë vëllezërit, motra, e fëmijët e mi. Unë iu fola për peripecitë

e Kristofor Kolombit. Ata mbetën të mahnitur, nga përshkrimi im historik. Ato ditë, nisa të mësoj një numër të ri cirku. Fillova stërvitjen me shtiza e shigjeta, gjatë gjithë dimrit. Arrita të gjuaj nga fundi i palestrës; nga korridori, gjer te tabela, plot dhjetë metra. Tabela ishte një trung peme, i prerë si kulaç. Në qendër, kisha vendosur një rreth me diametër njëzetë centimetra. Shtizën e hodha në qendër, si dhe tri shigjeta, me harkun e çeliktë që kisha përgatitur.

Të nesërmen, u bëra trajnim arinjve. Arusha Mira, rrinte e ulur në karrige me komandën time; ndërsa arusha Zana, rrinte shtrirë.

Arturi po përparon mirë në mundje, cirk, peshëngritje, krahas shkollës.

**20.11.1968.** Sigurova abonimet në të gjitha organet e shtypit për cirkun, me qëllim që të zhvilloheshn akrobatët dhe mundësit e mi nga intelekti. Në ora tre pasdite, cirku dhe estrada, u nisën për në Përmet. Rruga e asfaltuar, na dha mundësi që autobusi të ecte pa u tronditur, për të parë me interes Grykën e Mezhgoranit, edhe pse binte shi i parreshtur.

Mbërritëm drejt e në skenë. Shfaqja u prit ftohtë nga vendasit. Në darkë hëngrëm rëndë, po gjëra pa mish. Fjetja u bë në turizëm e shkëlqyer, me njëqind lekë krevati. Perdet ishin luksoze, krevatët dhe kaloriferët. Paradite bëmë shëtitje, dhe përsëri shfaqje.

Përmetarët, më vështronin me vëmendje dhe të habitur. Ata kishin katër vjet pa më parë, qysh kur ika më nëntë korrik të vitit 1964, me trap nëpër Vjosë. Ata më përshëndetnin me respekt dhe kujtonin "lundërtarin" e



madh të Vjosës”.

Bëra një vizitë në varrezat e dëshmorëve. I kishin punuar mirë. Pashë me vëmendje skulpturën e Odise Paskalit: “Vdekja e partizanit”. E studiova për një orë rresht, atë kompozim të bukur. Varrezat matanë urës së Vjosës, ishin rrethuar me pisha. Bisedova me rojen e varrezavë, i cili po dridhte një cigare nga duhani i vet.

Para se të jepnim shfaqjen e darkës, në skenë, shkova në stallat e kuajve të repartit ushtarak në juglindje të periferisë. Aty kisha shpurë pelën time të cirkut, për të bërë dashuri seksi, me një hamshor, gjak arab. Përmeti kishte fermë ushtarake, për shtimin e kuajve të ushtrisë.

Mëzen e bukur të cirkut, nuk e pashë më. Pyeta, por askush nuk më tha të vërtetën. Pasi këmbëngula, takova veterinerin ushtarak, që drejtonte ato punë. Ai kishte respekt për mua. Unë tek ai kuptova mungesa në kulturën jashtëprofesionale.

Leonorën e cirkut, e kishin dërguar së toku me kuajt hergjele, në kullotat verore të malit Postenan. Mëzja tre vjeçe arabe, e destinuar të vrapojë në fusha, lëndina, apo në shkretëtirat e Arabisë, nuk mundi t’i rezistonte rripave, përrenjve, gërxeve të thepisura e humnerave të Postenanit. Ajo kishte rrëshqitur mbi një shkëmb, dhe kishte nxjerrë artikulationin: kokso - femoral. Barinjte, nuk mund ta zbrisnin që andej. E kishin lënë të vuante, pa ushqim, e pa ujë, derisa dha shpirt e torturuar, derisa e përpiu vdekja e zezë.

I brengosur u ktheva në skenën e Përmetit. Në darkë, Pallati i Kulturës ngritur buzë Vjosës, u mbush plotpërplot. Njerëzit nuk gjenin bileta, hynë edhe me forcë. Suksesi

ishte i madh. Më sollën lulc në skenë. Ato mi dhuroi një vajzë e re. Edhe akrobatëve të mi, u dhuruan lule pionierët.

Në ora tetë të mbrëmjes, i hipëm makinës, e në nëntë e gjysmë, mbërritëm në Gjirokastër. Na pritën me mall. Kishin ardhur dhe mysafirë, e kjo bëri që të flinim keq. Ishim ngushtë. Banesa jonë, ishte një dhomë dhe një kuzhinë e vogël. Na mungonin dhe shtresat e mbulesat. Varfëria ishte sheshit.

Në mëngjes, u ngrita i përgjumur, me kokëdhimbje e qafë të përdredhur.

**21.11.1968.** Puna vazhdon me rritëm. Ca pikturë e ca stërvitje. Paspdreke, në çastin që po ngrija pesha, më filloi një dhimbje shumë e madhe në zemër.

**22.11.1968.** Dhimbje e fortë në zemër, në të njëjtën orë (18<sup>oo</sup>), sapo çova 87 kg, në momentin që nisa stërvitjen. Më pas, çova 100 kg, me duar mbi kokë. Dhimbja u bë edhe më e fortë nga shtatë pa çerek, deri në shtatë e çerek. Në palestër isha vetëm me Arturin, djali im besnik. Pak më parë, ishte dhe vëllai im i vogël, Xhovani. Më pa që isha keq, e as pyeti fare ciniku. Doli jashtë për qejfin e tij, së bashku me Ilen, dhe një ushtar, që kishte ardhur t'i takonte, duke më lënë në një gjendje shumë të rëndë. Hoqa tutat dhe u veshu me kujdes. Vendosa të eci ngadalë, në drejtim të prindërve në Palorto. Sa kalova gjimnazin, diku pranë furrës së pjekjes, më kaloi dhimbja e tmerrshme, që me detyronte mos të merrja dot frymë. Arturi më mbante krahun, me doçkën e tij e me pyeste: "babi, a të dhemb shumë zemra"? Unë pas një hopi i dhashë përgjigje, me

një frymëmarrje të dobët e të cekët, superficiale: “mos më folë, të lutem”! Ecja si i mpirë, si i vdekur.

Takova prindërit dhe vëllezërit në Palorto. Zemra më cimbiste. Qëndrova pak, e ngadalë - ngadalë u çova në këmbë. I përshëndeta dhe u largova. “Shko vizitohu. Mos e lër pas dore dhimbjen në zemër”, - më porositi nëna. Arturi i vogël më mbante nga krahu, gjer në fund të Hazmuratit, ku kishim shtëpinë, ngjitur me shkollën e Mesme Pedagogjike “Pandeli Sotiri”.

Fare papritur më kaloi dhimbja e tmerrshme. Dukej sikur po kalonte ndonjë tapë gjaku dhe shtrëngonte enët koronare, apo kapilarët e panumërt të zemrës. Sigurisht që kisha miokarditis reumatizmalis. Ky inflamacion i muskujve të zemrës, vinte si rezultat i lagështirës të madhe që kishte xhamia. Nga muret e saj kullonte ujë. Çatia shumë e vjetër, ishte prishur. Unë u interesova shumë për xhaminë, në emër të cirkut. U kthye çatia, e më pas, u suvatuan muret. Dyshemenë e shtruan me parket. Punimet i realizoi ndërmarrja më e fuqishme N.SH.N-ja. Sidoqoftë, unë goditjen e kisha marrë.

**23.11.1968.** Punë, telashe, stërvitje, dhe,... përsëri dhimbja e zemrës.

**25.11.1968.** Na dhanë dy dhoma e një kuzhinë dhe e anuluan. Isha njeri i rregullt dhe i ndërgjegjshëm. Koha u ftoh me ritëm të shpejtuar. Natën zemra më dhëmbi përsëri.

**26 11.1968** (e premte) U zgjova i këputur e i përgjumur. Kur dola jashtë, ndjeva se bënte shumë ftohtë. Bora

kishte mbuluar dheun 2-3 cm. Mikeli më ndoqi me topa bore, mandej u tur me vrap në kuzhinën e nxehtë.

**2.12.1968.** Në mëngjes, i lexova mamasë time dhe Fridës, tregimin që porsa mbarova: “DIKUSH PO TROKET”, prej 39 faqesh. Rreth orës njëmbëdhjetë e gjysmë, u nisëm në drejtim të radioskopisë. Mjeku A. Tefa tha: “ke zmadhim zemre”. Sigurisht që Alekua nuk kuptoi asgjë, për shkakun e dhimbjes time. Ai është kufizuar te fakti i njohur, se sportistët kanë zmadhim fiziologjik të zemrës, nga puna e madhe që bën muskuli i zemrës. Dhimbja e zemrës nuk pushonte. Bënte pauza dhe rishfaqej.

Nga spitali poshtë, u ngjitëm për në ambulancë, lart në qendër. Kërkuam kardiologun, Kristaq Dukën, po nuk e gjetëm. Aty më ndodhi ky fenomen: sapo u ula në stolin e klinikës, zemra më dha një thikë. Ngadalë-ngadalë, u çova në këmbë. Nuk gjetëm mjek për hallin që më kishte zënë. Përsëri zbritëm me këmbë, e ngadalë - ngadalë morëm rrugën për në spital. Zemra nuk po më qetësohej. U alarmuam. Frida, duke ecur, më thoshte sypërlotur: “e zeza unë për ty more Raqi, ç’më pësove kështu!”. Unë, i veshur me peliçen jeshile kanadeze, ecja ngadalë. Kushdo që më përshëndeste, i buzëqeshja. Nuk doja ta jepja veten. Ku ta dinin qytetarët, se Herakliu i tyre, ishte në buzë të varrit. Në rrugë takuam Koço Andonin, mjekun patolog me përvojë. Ai, me indiferentizmin e tij, nuk çau kokën fare për mua. Unë e dija, që asnjëri prej tyre, nuk kuptonte asgjë. Te porta e oborrit të spitalit, takuam drejtorin, Adem Harxhin. Ai tregoi habi, po jo shqetësim e përkushtim. “Ti je divë, o Sotiraq, ç’është kjo zemër që thua”. - Qeshi, po

nuk u kthye mbrapsht për në spital, të mblidhte enkas një komision të gjerë mjekësh dhe të konkludonin diçka për qytetarin e thjeshtë, për një njeri, paçka se isha koleg, artist, dhe i njohur personal i tij. Ademi u largua i qetë, në këmbë për në shtëpinë e vet. U futëm përsëri në spital. Mjek roje, ishte Hodo Çela. Ai u tregua i kujdesshëm, më vizitoi, por nuk kostatoi gjë. Njoftoi Kristaqin në shtëpi. Pas dy orësh, kur erdhi kardiologu me ambulancë, natyrë më ndihmoi e më liroi ajo krizë e gjatë. Kisha dëshirë të shtrohesh në spital, sepse kështu, diçka do të bëhej. U bëra prapë i sëmurë. Kristqi e kuptoi dëshirën time, dhe vendosi të më shtronte.

**3.12.1968.** Mbrëmë Arturi fjeti me mua në spital. Xhan i babit, besniku i babit. Sot më vizitoi Frida, Miçua, Kaçi, Lekua, Pavli, Stavri. Jam disi më mirë. Zemra më rëndon. Në darkë, më dha ca ngacmime të lehta.

**4.1.1968.** Jam diçka më mirë. Nga preparatet përdor: vitamina B12, tre herë nga dy tableta, tiaminë ose antineurinë. Këto i pranoj, pasi pranoj origjinën nervore të dhimbjes. Në darkë, para gjumit, fërkova gjoksin me unguentum camphoratum. Diçka dha rezultat. Natën vonë, erdhi Frida me Dianën nëpër shi e tufan. Qëndruan deri në ora dhjetë të natës.

(Në ato vite njerëzit lëviznin ditë, natë, pa pikë frike. Kush guxonte të bënte prapësira, e priste dënimi i rreptë. Pas viteve 1990, është keqkuptuar liria dhe demokracia. Në vendet perëndimore, policia ia beh për dy minuta nga marrja e sinjalit, edhe për vjedhjen e një pantalloni).

**6.12.1968.** U zgjova duke përshëndetur me të qeshura, e skica të shkurtëra humoristike, shokët e dhomës. Pasdreke u bëra pesimist. Tensionin minimal e kisha shtatë, maksimalin dhjetë. Rrashë për gjumë, po nuk fjeta. Mendoja zhvillimin e novelës: “DIKUSH PO TROKET”. Mjeku më tha: “nuk ke gjë, veç diçka nervore të jashtme”. Kjo ishte një përgjigje shkel e shko. As që bëhej fjalë për diagnozë të saktë pa bërë mjekimin. Mu kujtua shprehja romake: (Natura sanat, medikus kurantur (natyra shëron, mjeku kuron).

Erdhi Frida. Kur më pa ashtu të zverdhur, qau me lot të nxehtë. U konsultova me Kristaq Dukën, Thodhori Raftin, Polo Ramin, dhe vendosa të dal nga spitali. Në dhomë kisha marrë kitarën, dhe kur i bija me pasion, mblidheshin të sëmurët edhe ata të dhomave fqinje, apo personeli sanitar. Kur dola nga spitali, u përshëndeta përzemërsisht me të gjithë. Më përcollën gjer te dera e poshtme. Gjer në shtëpi më shoqëronin pëllumbthat e mi të dashur, Arturi, Diana dhe Mikeli i vogël. Rrugës ecja ngadalë-ngadalë. Më binin djersë të ftohta. Në shtëpi, vinte erë lagështi nga çarçafët e larë. Fjeta si qengj në folezën time.

**7.12.1968.** Mëngjes. Kisha djersitur, po u gdhiva mirë. Këndova melodinë e kompozuar para se të shtrohesh në spital. Fëmijët u kënaqën. Kënduan me mua bashkë. Mëngjesi ishte pa shi, po i ftohtë. Mezi u ambientova. Sapo dola jashtë, pata një marrje të lehtë mendsh.

**8.12.1968.** Në mëngjes u ngrita i djersitur. Frida, e



papërtuar. Gatuan shpejt mëngjesin, drekën, merr kosin, lan, rregullon, kryen porosinë e duhura, bën planin e punës dhe sulet drejt autobuzit të orës gjashtë e gjysmë. Arrin autobusin dhe shkon në Frashtan. Mbushi katër vjet në fshat. I takon me të drejtë ardhja në qytet.

Unë, shkova në Komitet, për të marrë autorizimin për zgjerim, por,... ndërhyrje keqdashësisht. Dredhi, pabesi, ligësi. Vendimi ishte anuluar. Përsëri ngushtë, familja prej pesë persona. U dëshpëruam shumë.

**9.12.1968.** Dita e enjte. U gdhiva mirë, po gojën e kisha helm. U lava e hapa dritaret të ajrorej hyrja. Ishte gdhirë një ditë e kthjellët, me rreze të kuqe nga lindja. U frymëzova dhe u përgatita për vrapin e mëngjesit, po nuk munda ta realizoj, se s'kisha tuta. Malli për gjimnastikë, më detyroi të vishja patinat ushtarake, dhe kreuva disa lëvizje, në sheshin sportiv, para shkollës pedagogjike.

**Datë 10-17.12.1968.** Gjithë këto ditë nuk bëra gjimnastikë, nga frika e zemrës së sëmurë. U mora me novelën: "NË GJURMË TË ARIUT". Punë me vullnet të hekurt.

**21.12.1968.** Fillova vrapimin për në Virua. U nisa nga shtëpia në ora gjashtë. Ishte mjegull. Vesha dy bluza. Mora në duar dy gjyle. Vrapova pak, po më shumë marsho-va. Shijova një mëngjes të bukur. Pashë shkumëzimin e kataraktit, poshtë urës së Viroit. Pamja e liqenit me mjegull, hijeshonte mëngjesin. Drita e lindjes reflektonte në ujë. Këtë bukuri e futa në zemër, për poezinë e këngës time:

**“DËSHMOREVE”.**

Pasdreke, në palestër, bëra stërvitje mjaft të rëndë me shtangë. Mbajta edhe tubon në ballë, me një akrobat në krye. Në darkë, sa u ktheva në shtëpi, fjeta si i vdekur. Kur erdhi Frida nga vizita në prindërit e saj, më gjeti në gjumë të thellë.

**22.12.1968.** Në mëngjes u ngrita si i kalbur. Vajta me vrap në Virua. Dita kaloi me punë të shumta. Përgatitja e cirkut për natën e vitit të ri. Në darkë punova me shtangë me fëmijët e mi.

**24.12.1968.** E premte. Punë,... Frida gjatë gjithë natës, sonte holloi bakllavanë për vitin e ri.

**25.12.1968.** Vrapova drejt Viroit me mjaft qejf. Gjatë ditës, ndjeja lodhje në këmbë, po jo në zemër.

**29.12.1968.** Bie shi. Vrapimin s’po e bëj. Kam punë të panumërta.

**30.12.1968.** Dita e sotme kaloi me punë nga më të ndryshmet. Vrapimin gjer në Virua e kreu me sukses. Atletiket më janë prishur e copëtuar. është diçka e tmerrshme të imagjinosh, se janë blerë 45 palë të tilla, dhe mos të ketë atleti i vetëm serioz i Jugut.

**31.12.1968.** Gëzuar, gëzuar! Shtëpia na u mbush me vëllezër e farefis. Gëzuar! Te ne gjetën gjithë të mirat. Kur shkua me te ata, serviren një gotëz vodkë pa meze. Hajt

gëzuar!

**1.1.1969.** Gëzuar! U ngrita në ora tetë i trullosur e i përgjumur. U nisa me vrap për në Virua. Mezi vrapoja. Dita ishte e bukur e me mjegull. Bëmë vizita dhe pritëm miq. Gëzuar!

**16.1.1969.** Unë dhe Frida, mbushëm dhjetë vjet martesë. Urime! Dhe njëqind krah për krah.

Vrapi tradicional për në Virua. Punë të ndryshme në zyrat të Komitetit Ekzekutiv. Vajta në N.SH.N. te saldatori. Preva një balestër makine më dysh për së gjati. Me ato fije çeliku special, përgatita dy harqe të fortë. Menjëherë u ngjita për në xhami, dhe provova në palestër, nëse kishin fuqi ta hidhnin shigjetën në tabelë. Shenjë nuk merrja dot. Përgatita dhjetë shigjeta me dru. U vendosa maja hekuri, të fiksuara mirë me gëzhojat e fishekëve. Provova, por shenjë nuk merrja dot. Shigjeta hidhej gjer në tabelë e përplasej me forcë. Ky rezultat, më ngjalli shpresën e hershme, që të gjuaja me shigjetë kokrrën e mollës, vendosur mbi ndonjë skulpturë komplete, nga koka e gjer në këmbë. Kisha përgatitur “gjimnasten skulpturë”. Mollën e vendosa mbi kokën e një qeni të stërvitur enkas, ulur në qendër të tabelës. Arrita të gjuaj mollën. Qeni, nuk ikte nga stativi ku qe ulur, por dridhesh e rënkonte, në çastin që hidhja shigjetat mbi kokën e tij. Ky numër, ishte një lloj ngjasimi, me atë të dramës: “VILHELM TEL”, të Frederik Shilerit, ku babai gjuetar, goditi mollën, mbi kokën e djalit të vet, me urdhër të mbretit.



## Zjarr në akull

Pamje dimri. Malet rënduar nga mjegulla. Përrenjtë dhe greminat duken dhe më të zymta nga retë e shiu. Megjithatë edhe kështu, ka një farë madhështie. Një panoramë gri si e sotmja, hodha dje në telajo. Punët e shumta ma vodhën paraditen. Koha kur s'shtyhet, bëhet monotone, si pikat e strehëve të çatisë. Kishte kaptuar mesdita kur u ktheva në shtëpi. Rrugës meditoja: zemrën e kujtoj, dhimbja të më ketë harruar? Është fshehur? Është larguar përgjithmonë? Ç'tmerr që kam hequr. Më zuri befas në palestër duke u stërvitur në peshëngritje. Vëllai i vogël u largua pa çarë kokën. Eh, vëllai,... Biri im, Arturi, 7 vjeçar, më mbante nga krahu me sy të përlotur, duke më pyetur: "Babi a të dhemb shumë"? Kështu vazhdoi për disa ditë dhimbja e fortë e befasishme, më shtrëngonte sa mezi merrja frymë. Ç'që kjo e papritur? Unë ndjehesha një vullkan në shpërthim. Vazhdoja me pasion punët e mia në art, në pikturë, skulpturë, cirk, kompozim. Vazhdoja me vullnet të hekurt stërvitjen: herë në peshëngritje, e herë në

mundje e boks. Dita hapej me vrapimin gjer te Liqeni i Viroit. Vazhdoj dhe punën time të përditshme mjek zooveteriner. Kaq shpejt u lodh zemra ime? Ç'është ai duf i dhimbjes?! Po kolegët, mjekët? “Ti je si divë, o Raq”, - më tha drejtori i spitalit. “Nuk kuptoj ndonjë gjë me rëndësi”, tha mjeku roje. Një mjek tjetër më tha: “Ti mbreti i gjimnastikës të kesh dhimbje, ti i sëmurë? Duhet të kesh zmadhim zemre nga sforcimet”. Më shtroi kardiologu në spital, u mjekova e sa kam dalë nga spitali. O zemra ime kaq shpejt po dorëzohesh?

Këto mendime më trokitën në kokë, gjersa arrita të trokasë në portën time.

\* \* \*

Frida, vinte vonë nga shkolla. Hëngrëm shkel e shko fasule të ftohta pa mish, me vaj kikiriku, e që i vinte era vaj balenç. Buka si gur. “Sa të shijshme që hahen”, - tha Arturi. Janë të shijshme vërtetë, i thashë unë, duke menduar urinë e varfër. Ftohtë. Pas të ngrënit, dimri i vogël u bë i madh. Na pushtoi drithërima. “Jemi të humbur, - tha Diana, - të ndezim sobën”. U tur në depon e druve, e u kthye sakaq, me ca dru të gjata, që s’i nxinte hyrja e sobës. Jeni të vegjël, o pëllumbesh e babait, nuk jeni të humbur, i thashë unë. Rrëmbeva drutë, mora sëpatën e rëndë, dhe dola jashtë për t’i prerë. Binte shi. Hyrja jonë e vogël, për liliputë, ishte

në katin e parë të pallatit pesëkatësh, ngritur në majë të kodrës. Dritaret shikonin nga jugë lindja, po krahu tjetër, ishte i nëndheshëm.

Preva drutë, u futa brenda, i vendosa para sobës e i thashë Arturit: “Shpirt i babait! Të lutem, ndize pak sobën”. Arturi hodhi pak hi në një kuti konservash, dhe e spërkati me vajguri. E futi në sobë, e mbi të vendosi me kujdes druçkat e pelekudhat e holla, pa i zënë frymën zjarrit, që i rrëmbeu me të hedhur shkrepësen.

Të tre fëmijët dhe unë, zgjatëm duart e thara mbi sobë. Pas pak edhe kuzhina e vogël e nëndheshme, filloi të ngrohej. Faqja e nëndheshme e saj, kullonte bulëza uji, sikur djersinte. Ngrohtësi. “Ooo, sa mirë”, - tha vajza. “Shumë mirë”, thashë unë, duke ndjerë ngrohtësinë mes zoçkave të mi, dhe “serumin” e zjarrit në enët e gjakut. Dhembja e zemrës kushedi ku ishte fshehur, kushedi ku qe larguar.

\* \* \*

Në portën e jashtme dikush trokiste. Ishin të pandërprera, këmbëngulëse. Fëmijëve u bëri përshtypje. U ngrita për ta hapur. Përpara meje qëndronte shefi i krimeve, shoku V. Pas tij, në fund të shkallëve, ishin dy oficera sigurimi dhe shoferi i Degës. Unë i njihja. Para



kur bënin gjimnastikën e detyruar të mëngjesit. Mendja vetëtimthi më shkoi tek e keqja. Policia s'të var medalje, po të vë byzylykët. Të kisha bërë ndonjë faj? Ndërhyrjet mjekësore i kisha bërë lege artis ( në mënyrë artistike). Të kisha lëshuar ndonjë fjalë pa vend? Gjithmonë kam qenë i matur, e s'pleksesha nëpër kafene. Të qe rrëzuar ndonjë akrobat në palestër, e kishte vdekur? Shpesh herë, ata futeshin nga dritaret, stërvitëshin, loznin. Unë mbaja çelësat e dyerve të mbyllura në xhep. Dyshonin se mos merresha me ndonjë spiunazh ndërkombëtar, meqë bëja stërvitje titanike? Zoti na ruajtë nga këta njerëz, thashë me vete. Mos vallë ishte problemi i allçisë që bleva me autorizim për skulpturën? Vepra fitoi ÇMIMIN E PARË, dhe ziliqarët, mund të kishin trazuar punët, ... Truri im, i analizoi që të gjitha rrufeshëm.

- Mirëdita. Urdhëroni brenda, - u thashë mysafirëve. Shefi buzëqeshi. "Na ka zënë një hall i madh", - më tha mua. - Ç'ka ndodhur? - e pyeta unë me atë mimikën që shpreh habinë dhe përsëri u thashë urdhëroni brenda, në hyrje të bisedojmë. Të paktën pini dhe një gotë raki a një filxhan kafe. - "Nuk na pret puna. Të lutem, vishu shpejt dhe eja me ne", - foli i qetë e me mirësjellje shefi i krimeve.

Unë dyshova te kjo urtësi e tij. Kështu e kanë sigurimsat, thashë me vete. Sa të hedhin prangat, pastaj ta rregullojnë qejfin. Të rrasin në qeli dhe e pëson si Edmond Dantesi, ose i mjeri Zhan Valzhan.

- Më thoni përse më doni dhe ç'farë ka ndodhur? - e pyeta unë me guximin tim karakteristik. Shefi, jo pa qëllim e binte vërdallë, përse më kërkonin mua. Ai, duke më trembur, mendonte se ia arrinte qëllimit, për të më urdhëruar

“Na është mbytur një njeri në Liqenin e Koshovicës dhe vetëm ti mund ta nxjerrësh”. - Ua sa keq, - fola unë, duke shprehur keqardhjen time dhe pasi u mendova pak e pyeta: - Si ka mundësi të mbytet njeriu në liqen, kur në dimër nuk lahet kurkush?” Hajde vishu, pa ta shpjegoj në makinë”, - më tha njerëzishëm, e jo me ton urdhërues. - Një minutë do të më prisni, sa të vesh patinat ushtarake, se jashtë bie shi, u thashë mysafirëve të paftuar. “Vishu mirë se bën ftohtë, vishu trashë,” - më porositi shefi i krimeve. Vешa një bluzë tutash, mbështolla qafën me shall e në korridor po vishja patinat. Në atë çast u hap dera dhe hyri Frida. Më pa e shqetësuar dhe më pyeti: “Ç’ka ndodhur? Ç’janë këto makina të policisë jashtë në kalldrëm”? Mos u tremb i thashë dhe e putha për ta qetësuar. Është mbytur një traktorist thuhet,... po është zhdukur dhe traktori nga faqja e dheut, sqarova, duke veshur peliçen e trashë. “Po pse ti do ta shpëtosh qeverinë? Ç’je ti që rrezikon jetën dhe me një zemër të sëmurë? Policia le të mbajë notarë me rrogë. Raq, të lutem mos ik, mos na nxi jetën”, - më tha gruaja.

Mos u tremb, nuk më gjen gjë mua. Kujdesu për fëmijët se po na shikojnë me frikë. Putha zoçkat e mi, Arturin, Dianën, Mikelin e vogël, trevjeçar, e dola me vrap. Zbrita shkallët e zura vend në xhips, pas shoferit, i shtrënguar pas katër oficerëve, të veshur me xhupa si jorgan, të stilit kinez, dhe me automatikë para këmbëve. Makina zbriti atë copë rrugë poshtë pallatit tonë, kufiri i fundit i lagjes, dhe u kthye djathtas në rrugën nacionale. Binte shi i imët me borë, llohë bore. Duke kaluar postbllokun, pas vinin dhe dy makina të tjera me oficerë. “Po vjen dhe kryetari i degës”, - tha shefi i krimeve, dhe iu këput koka

duke shikuar prapa, derisa ata na parakaluan. Pesë makinat kaluan rrepet e SMT-së, Lazaratin, Dervicianin, Goranxinë, Vanistrën, Haskovën, Sofratikën, Frashtanin, Grapshin, Jorguacatin, si dhe me radhë të gjithë fshatrat e Dropullit të Sipërm. Faqet e malit mezi dukeshin nga mjegulla. Ato ishin të mbuluara nga dëbora, vetëm në fund të tyre, aty - këtu, fshatrave nxinin. Këmbët më ngrinë. Ishim të varfër dhe të pakujdesshëm. Bota mbarë, edhe të parët tanë, kanë përdorur çorape prej leshi. Brenda në makinë, dëgjohej vetëm zhurma e motorrit dhe rrotat që rrëshqisnin mbi asfaltin e lagur. Të gjithë kishin rënë në mendime. Mu duk vetja, për një çast, si një qen që përdoret nga policia, për të zbuluar njerëzit e mbuluar nga orteku i borës në alpe. Një mendim tjetër e dëboi të parin. Ishte mbytur një njeri dhe patjetër duhej gjetur. Unë duhet ta kryeja këtë detyrë tejet të vështirë, nga spitali në kallkanin e liqenit. Në vesh më bëhej cicërima e djalit të vogël kur u ndava prej tye. Po sikur,... Zemër, thashë, bëhu e fortë, e si gjithmonë më bëj të fortë.

\* \* \*

Papritur u gjendëm te “Liqeni i Vdekjes”. Kështu e quajta. Si mjek zooveteriner, kisha qënë shumë herë në ato anë. Me minoritetin kemi pasur shkuarje shëmbëlllore. Edhe krushqi kishim bërë. Kisha shumë shokë e miq minoritarë.

Kur pashë atë liqen të madh, aty rrëzë malit, si ai i Belshit, u befasova. Ishte ndërtuar me një digë të madhe,

mur guri e betoni. Liqeni ishte i thellë, hijevrenjtur, shumë hijerëndë dhe nga moti, e tepër i heshtur.

Makinat erdhën rrotull tij dhe ndaluan në pikën kodrinore, kundruall digës. Me të zbritur unë, oficerët e degës më rrethuan. Kryetari, më zgjati dorën dhe buzëqeshi me respekt. Vinte nga klasa. Dikur ishte marangoz. Banonim në një lagje. Kur shoku N. u rrit në pozitë, mori hyrje të zgjedhur, si gjithë autoritetet. Në atë çast m'u afruan shumë njerëz, me dhjetra, e më jepnin dorën me mirësjellje: "Ti chome Sotiri"? (Ç'kemi Sotir?). I njihja dhe më njihnin. Shumë s'i njihja dhe më njihnin, ndoshta nga cirku, të cilin e krijova familjarisht me aq përkushtim, ndoshta nga rubrikat e lajmeve për "bëmat" e mia si udhëtimi me trap nëpër Vjosë, etj., të cilat i bëja me mjaft pasion. Unë përshëndetja me shumë respekt e përzemërsi, gjithë ata njerëz të thjeshtë e të ndershëm.

Isha vetëm 29 vjeç kaçurel, me mustaqe të zeza sterrë si xhufkë, që kur buzëqeshja, bënin kontrast me dhëmbët borë të bardhë. Kisha një trup mbi mesatarin, të lidhur e tepër të kalitur. Do të ishte krim i madh, në rast se unë do të pësoja një atak zemre, porsa të futesha në liqenin e ftohtë me buzë të akullta.

Zbrisnim anës së liqenit. Ecnim mbi akull. Balta e kuqe kishte ngrirë, dhe secili ecte me kujdes se mos rrëshqiste e çante kafkën. Më takuan disa personalitete të rajonit. Traktoristi kishte qenë minoritar, i ri, kollos, i martuar, përkushtuar punës me gjithë shpirt. Po ç'u bë? Ku vajti?...

"Ka dy variante, - tha shoku N.: o është mbytur, o është arratisur. Në rast se është arratisur në Greqi, na nxin

faqen se ishte komunist. Në rast se ëshë mbytur, familja e do kufomën, prandaj duhet kërkuar. Nga ty varet gjithçka”.

Informacioni kishte shkuar gjer lart. Alarmi ishte dhënë. Ministria e Brendëshme, kishte urdhëruar degën e brendëshme të gjendej traktoristi i zhdukur: o i gjallë, o i vdekur. Në degë, në pushtet, në parti, kishte rënë zija për komunistin e zhdukur. Bëheshin plot pesë ditë dhe asnjë lajm, asnjë njoftim, asnjë sinjal, asgjë, asgjë. Të gjithë e kishin pisk se,... se,... fluturonte edhe karrikja.

Ishte palca e dimrit. Kush mund t’a zgjidhte enigmën? Kush mund t’i çlironte nga laku i hedhur? Kush kishte dhënë prova? Mendja, menjëherë u shkoi tek Raq Paskal, protagonistin e shpëtimit të sa njerëzve, ose nxjerrjes të të mbyturve, në lumenj, rezervuarë, liqene e në det. Po kishin menduar edhe për mua, se në këtë dimër të egër, po sikur të më ndodhte gjë? Tirana, kishte dhënë urdhër dhe priste përgjigje urgjente, kështu që,...

Në grupin e oficerëve, ndodhej dhe shoku A, person me përgjegjësi në organet e pushtetit. E njihja qëkurse ishim student. “E kisha kunat, vëllanë e gruas, - më tha me lot në sy. - Ai kurrësesi s’e ka kryer aktin e arratisjes. Në rast se e ka bërë, na morri në qafë”. Me Grecinë ishim thikë e në pikë.

S’kishte kaluar shumë kohë, kur shikoj buzë gropës gjigande, mbi murin e gjerë pesë metrosh, rreth dy mijë njerëz, një kortezh i hapur, të mërzhitur e të ngrirë si trungje. Mbi kokë, mali i mbuluar me borë, e cila zbardhonte pyllin e errët me bredha, pisha e gjithfarë drurësh, me një kontrast ekstrem. Matan pyllit ishte toka greke, kufiri. Mjafton të kapërcëjë atë faqe të pyllit të pjerrët dhe hyje në Greqi. Të

aratiseshe?! As ndërmend nuk i shkonte kujt. Një breshëri automatiku, ta ndante më dysh kafkën. Aq frikë ishte futur, saqë po të ishe në makinë, duke ecur në rrugë nacionale dhe të ktheje kokën nga kufiri, ose të pyesje e të tregojë me gisht, telat me gjëmba të klonit duhej të mendoheshe mirë. Një sigurims të studionte mirë, se mos kishe në kokë plane arratisjeje,...

\* \* \*

Të gjitha variantet i kishim diskutuar: polombarët çarja e digës, motopompa, arratisja. Përfundimi pas pesë ditësh: trokitja në portën time. Muzgu po afrohej si pa u kuptuar. Unë hoqa peliçen e trashë e në çast dikush e morri në duar. Hoqa bluzën, pantallonat dhe ndjeva të ftohtë, kur hoqa këpucët. Mishi i shputave të këmbës shkeli në llucën e ngrirë. Ashtu, me mbathjet e kuqe të banjës, trupi im i bardhë, shëmbëllente si një ndriçim fosforeshent, në sfondin kafe në të zezë të baltës, ku kishte punuar traktori. Traktoristi kishte punuar gjatë gjithë verës e vjeshtës, duke marrë baltë nga lliqeni i shteruar, që vadiste fushat e gjera me misër. “Stalinci”, ishte një traktor gjigand, shumë i lartë dhe i gjerë. Në Luftën e Dytë Botërore, thonë se u adaptua dhe si tanks.

Traktoristi, e kishte thelluar goxha lliqenin e zgjeruar mbi njëqind metra. Baltën e shtynte me ruspën e madhe,



drejt rrëzës së malit. Unë me intuitën time, e kuptova sesi mund të kishte punuar traktoristi. Ai ecte mbrapsht ku fillonte ujët në buzë të liqenit dhe e ulte ruspën në tokë. Siç thoshin punonte shumë, që nga mëngjesi deri në darkë vonë, sa nuk shikonte më. Ashtu punonin traktoristët e gjithë punonjësit e SMT-së, në kohë fushatë. Po edhe stërmundimi shton rreziqet, kur harxhohen tej kufirit energjitë. Tek po ecja mbi akullin që po thyhej me kërcitje poshtë këmbëve të mia, me kokë të ulur duke iu drejtuar ujit, mu afrua një burrë i shkurtër duke më folur: "Sotiri! Ego ime o pateras tu Vangjeli". (Sotir! Unë jam babai i Vangjelit). Unë i shtrëngova dorën dhe u preka, tek pash lotët e plakut, që kullonin çurk nga sytë e rreshkur, në faqet e fishkura me brazda, deri në qafën e hollë me lapa. Emocione, po në atë çast nuk mund të qaja. Nuk kisha kohe të qaja. E pashë në sytë e skuqur, dhe dorën time ia vendosa butë - butë në faqen e majtë, të ftohtë, tepër të ftohtë. Ishte mbledhur kruspull nga hidhërimi. Kur fytyra e tij e akullt u mbështet në trupin tim, kapelja i rra nga koka, duke lënë të zbuluar tullën me rrudha e flokët e bardhë. U përkula, mora kapelen dhe ia vendosa në kokë, pa i thënë asnjë fjalë. Bëra një hap para. Duart mbanin për kurajo, krahët e tij skeletor, ku kishin ngelur vetëm dy kockat e humerusit. Sytë i kisha drejt liqenit. U shkëputa nga babai i gjallë, për të gjetur birin të vdekur. Ecja anës së liqenit, ku shtresat e akullit thyheshin si xhama, kërcisnin e copëzoheshin si kristale. Tri metrat e para të cektinës ishin mbuluar me akull. Në thellësi, ujët ende nuk ishte kristalizuar. Isha i ri, zjarr në akull. Në çdo hap që bëja mbi akull, më dukej se lëshoja avuj. Copat e akullit dukeshin si të bardha, po poshtë tyre, uji i liqenit

ishte i zi prej argjilit. “Liqeni i vdekjes” ishte me ujë dhe baltë të kuqërreme në kafe. Ajo mu ngjit në këmbët e mia. Sa herë çoja njëren këmbë nga tabani i liqenit, më fundosej e më ngjitej këmba tjetër. Instikti natyral i vetmbrojtjes, më kujtoi rrezikun e mbytjes, duke u fundosur në llucën argjilore të nënujëshme. Ajo, po më mbante në vend, duke mu ngjitur si tutkall. Të dyja këmbët mu fundosën deri poshtë gjunjëve. O Zot! Po më gëlltit balta më të poshtë tabanit të liqenit, thashë me vete. Në pleqëri njeriu pshehrëtin e flet me vete. Kisha parë e dëgjuar njerëz që flisnin me zë. Unë akoma isha i ri. Ky të ishte fundi i palavdishëm, ende pa filluar kërkimin? Mendohej se liqeni i zi, kishte gëlltitur traktorin e stërmadh, e bashkë me të traktoristin dhe ja tani,... Që në momentin e parë rrashë në kurthin e vdekjes? Ajo gajasej fërkonte duart? Goja e saj kockore me mandibulen e shqyer, ishte ujët e zi, ndërsa kthetrat e gjata të saj, ishin balta ngjitëse, që më kishte mbërthyer mua të dy këmbët, e po më tërhiqte në thellësinë e zezë.

Nga brigjet shkëmborë të lumenjve të vrullshëm e të deteve, kisha kërcyer me artin e zhytjes e të kërcimit, po në kënetë nuk kisha ngecur ndonjëherë. Ata që e kanë provuar këtë lloj ankthi, ose që kanë dëgjuar si vdesin njerëz në kënetë, më kuptojnë lehtë.

Në plazhin e Durrësit apo të Vlorës, vërtetë ecën nëpër ujët e cekët të detit, derisa të futesh në thellësi e të notosh, po tabani i detit është i fortë, solid. Kisha lexuar sesi një grup kalorësish, tek ecnin në rërën anës detit, u fundosën në të, pasi ajo ishte bërë si pelte.

Mbi dy mijë njerëz më shikonin vëmendshëm në hesh-

-tjen ogurzezë. Në atë kallkan janari, cili do guxonte të zhvishej, pa le më të futej në liqen e të më shpëtonte mua duke u mbytur që kërkoja të mbyturin? Beteja nisi e ashpër. Baltovina kërkonte të më kollofiste forcën, po zgjuarsinë? U shtriva barkas mbi ujë dhe u dhashë duarve përpara, duke hedhur trupin sa më përpara. Këmbët i shkula me zor nga balta, po koka mu fundos në ujë. Ngrita kokën lart dhe në çdo centimetër që shkundja këmbët prej llucës, hynte ujë, që e bënte më pak ngjitës argjilin. Uji më shërbeu si një lloj lubrifikanti. Me lëvizje energjike u shkëputa krejt nga baltovina, dhe ika para në ujë, duke rrëshqitur si një kaike druri e punuar me sëpatë prej afrikanëve. Shpëtova. Vetëm kllloçitja e ujërave, dëgjohej në atë heshtje varri. Njerëzit ishin kthyer në mumje, shikonin, po nuk kuptonin si unë luftoja e dola fitues në duelin e parë. Si një kaike mishi, notoja drejt qendrës së liqenit, me të gjitha shqisat e tendosura në maksimum. Zemra më rrihte shpejt, buh,... buh,... tup, buh; gjëmonte brenda gjoksit tim. Lëkura ekuilibronte të ftohtit e madh të ujit, me muskujt që ndjenin ngrirjen. Nervat dhe enët e gjakut u tkurën. Notoja në stil të lirë, e papritur ndalova në vend. Fillova në stil marinari, një lëvizje anash, brinjazi, në krahun e djathë, ku dora e djathhtë shtrihet përpara, ndërsa e majta dhe të dyja këmbët, e shtyjnë ujin mbrapa. Me këtë mënyrë lëvizja qetë, duke kontrolluar zonën përçark. Uji, duke mos qënë i tejdukshëm, po i përzier me baltë, nuk më lejonte të shikoja as këmbët e mia poshtë sipërfaqes, le më të shikoja në thellësi e në pjerrësinë rreth e rrotull liqenit. Pata ftohtë. E ndjeva gjer në palcë acarin, ngrirjen e ujit të dëborës. Balta sikur e shtonte edhe më shumë ftohtësirën.

Çdo ditë jam larë gjatë dimrit, edhe në dushet e ftohta të Institutit Bujqësor, edhe në ujërat e Vjosës, apo të Liqenit të Viroit, po ishin ujëra të pastërta, të tejdukshëm, të kristaltë. Jam zhytur brenda tyre në dhjetor, janar, shkurt, po nuk jam ndrydhur si në zymtësinë e këtij liqeni. Kërkoja me shpejtësi dhe preokupacion të madh. Isha në kërkim të zhardhjes të së vërtetës, kur muzgu sa vinte nxihej. Puna nuk priste vonesë. Isha lakuriq, qënie prej mishi, pa asnjë mjet mbrojtës. E mishi i njeriut është mish, ndjen, tkurret, vdes. Çdo sekondë qëndrimi, më tepër rrezikonte jetën time. Miliona raste njihen në botë, kur njerëzit vdesin sapo futen në ujë. Sa njerëz kanë vdekur në plazhe, pishina, lumenj. Sa njerëz kanë humbur jetën, nga ujët e ftohtë të frigoriferit. Zjarri po më shuhej. Vendosa të dal në breg. Notoja në krol, si delfin. Iu afrova cektinës, e cila filloi dhjetë metra para se të dilja në tokë. Fitova shpejt përvojë. Taktika e re ishte rrëshqitja mbi ujë, edhe pse ai ishte një pëllëmbë mbi llucë. Kështu rrëshqita në cektinë me not bretkose të qetë. Shkela mbi copat e akullit e u largova rreth pesëmbëdhjetë metra nga bregu. Acari që më kërcënonte jetë, mbeti te gropa gjigande. Dueli i dyte ndoshta një armëpushim. Enigma ende e pazgjidhur. Aty afër ishte ndezur një zjarr i madh. Instiktivisht u afrova. E ndjeva afshin e tij në lakuriqësinë time të ftohtë. U largova menjëherë. “Nrohu, ngrohu”, - më thanë disa burra njëherësh. Jo, jo, faleminderit, - u ktheva përgjigje me zë të ulët, e sqarova: e ftohta luftohet me të ftohtë, dhe e nxehta me të nxehtë. E thashë dhe latinisht: kontraria cotrris curentur ose sinilimus sinilima curentur (ngjashmëria shëron të ngjashmen). Mora xhupin tim, e veshja direkt në mishin e lagur dhe po vrapoja

mbi akull dhe mbi llucën e shkrirë nga qindra këmbë njerëzish, që vërtiteshin në bregun e squllur me ujë bore, duke pirë cigare pambarim, e duke biseduar e pritur në ankth. Qielli nxinte si toka dhe liqeni. Gratë qanin mbyturazi atje, në majë të pritës prej guri. Të gjitha ishin veshur në të zeza. Zezonin. Nëna priste të shikonte kufomën e birit të dashur. Babai thoshte me mendje: “Ç’e dua unë jetën para djalit të mbytur. A ka gjë më të rëndë për mua plakun, se të shikoj birin tim të vdekur”? Nusja kërkonte të shikonte për herë të fundit burrin e saj. Ç’dhimbje! Shokët, miqtë, farefisi, prisnin të dëshpëruar, prisnin. Partia dhe policia prisnin përfundimin e tragjedisë dhe,... Mbi të gjithë rëndonte si moti i murmë dyshimi: po sikur mos të jetë mbytur e ka ikur. Liqeni ishte akuzuar vrasës, dhe unë duhej ta vërtetoja këtë. Hidhërimi, gëzimi, lumturia apo ndjenjat e holla, kërkojnë qetësi. Deti kërkon shtrëngatë. Qielli i pastër dhe i kaltër, ndonjëherë pranon edhe... stuhi.

Unë isha i heshtur e nuk i flisja askujt. Dhe gjithë ata njerëz, megjithëse ishin veshur rëndë, kishin të ftohtë. S’gjenin ngrohje, se u kishte ngrirë shpirti. Ata ishin “spektatorët” më të vëmendshëm, e më gojëmbyllur në atë amfiteatër që kam njohur.

Në skenë kam korrur suksese të panumërta, madje edhe në stadiume. Mu kujtua, si në spartakiadën e Parë Kombëtare të Kooperativave Bujqësore në Korçë, fitova në mundje. Përfaqësoja Përmetin. Isha vetëm 22 vjeç, shtatë vjet më i vogël se në atë ditë janari. E munda kundërshtarin tim korçar. Përmetarët e ekipit tim, më ngritën në duar, nga tapeti i mundjes, gjer përpara tribunës së stadiumit. Çdo natë, mundja kundërshtarët, elbasanas, pogradecarë,

e të tjerë. Në Pallatin e sportit “Partizani” në Tiranë, munda kundërshtarë të “Flamurtarit” e “Studentit”. Sukses i madh. Oshëtima, brohoritje, fishkëllima të tifozëve e adhuruesve të shumtë. Para amfiteatrit të përzishëm këtu rrëzë malit, në këtë acar dimri, puna ishte krejt ndryshe. Nata po vinte e duhej filluar beteja e dytë.

\* \* \*

Pas vrapimit, hoqa peliçen e ia dhashë një të panjohuri, i cili e mori menjëherë. Vetëm vrapimi dhe disa ushtrime gjimnastikore më nxehën trupin, i cili ende ishte i mbushur me mornica. Mbylla paksa palpebrat e syve dhe nëpërmjet qërpikëve e kaçurelave, që më kishin rënë poshtë ballit, studioja gjurmët e panumërta, që kishin lënë zinxhirët e trashë të traktorit tanks. Gjurmët ishin me qindra. Ato shkonin pothuajse paralel. Liqeni ishte fryrë me ujë deri në krye të digës. Në anën ku po kërkoja, ujët ishte ngjitur goxha, po kishte fushë veprimi, hapësirë e krijuar nga puna e traktoristit. Vetja mu duk një hero i heshtur, që kërkoja një hero të vdekur. Po sikur mos t’ ishte,...

Tek studioja gjurmët e lëna e të ngrira, duke lëvizur shpejt, zgjodha njerën, që bindi intuitën time, si zezaku afrikan, apo indiani i Amerikës, që nuhat gjahun, rrezikun, armikun. Vrapova drejt liqenit, brenda asaj korsie që kishte ngrirë mbi tokë. Sa bëra dy hapa mbi llucat e nënujshme, u



shtriva barkas dhe notoja lehtas mbi spërfaqen e ujit pa u fundosur. Me gjithë kujdesin e madh, pesha ime e konsiderueshme mbi njëqind kilogram, bënte që gjoksi dhe këmbët e mija, të ndesheshin me llucat poshtë ujit. Rrëshqisja mbi lluca e mbi ujë i hapur e i shtrirë, me tendencën e zgjatjes përpara. Pas rreth tridhjetë lëvizjesh, kisha hyrë në thellësi të liqenit, pa ngecur në llucë, ashtu si herën e parë. Tek po ndiqja korsinë pa litar e pa tapa drejtuese, siç kanë pishinat e garave të notit, e mbajta drejtimin me imagjinatën time, sikur ecja mbi një tra ekuilibri ose mbi telin e cirkut. Lajtmotivi im më ngacmonte: heroi i gjallë kërkon heroin e vdekur. Po sikur,...

Bënte aq ftohtë saqë njeriu nuk mund të duronte më. Në tokë, frynte thëllimi i malit me borë të ngrirë. Kur dola ndjeva jo vetëm këtë acar, po edhe ftohtësirën e dështimit në sytë e oficerëve të degës, në sytë e oficerëve e ushtarëve të kufirit, që kishin zbritur me gjithë qentë e postës kufitare. Nëna, babai, familja, shokët e punës, e të gjithë ata që ishin shkukur nga fshatrat e tyre, mendonin se shpresa që e humbur, zhgënjimi po shfaqej si një fantazmë që ndrydhte më tepër zemrat. Versioni i arratisjes të traktoristit komunist, u bë i vërtetë në mendjen e secilit. Po traktori tanks ç'të jet bërë? Të ketë shkuar me traktor në Greqi? E pamundur.

Kur u zhyta në ujë, trupi më ndjeu një ngrohtësi të çuditshme, sikur u fut në vaskën me ujë të ngrohtë. Nëpër vaska të tilla lahashin vetëm udhëheqësit e familjet e tyre. Thëllimi i acartë mbi tokë, e bënte ujin e liqenit të durueshëm. Notoja në korsinë e gjurmëve të ngrira që zgjedha, kontrolloja, totalisht i përqëndruar me sytë poshtë

ujit, por,... Një gjë më të zezë se e zeza e thellësisë nuk po dallohej. Vetëm ujë në kafe të ërrët, vetëm ujë i turbullt. Luga në tasin e qumështit, që e linin kalamajtë brenda për mungesë oreksi. Qumështi i skremuar plus ujin e shtuar nga Frida e përsëri luga s'dukej në dy centimetra thellësi. Po traktori në një liqen disa hektarësh?

U bëra racional, e me veprime të përsheptuara veproja. Forcat po më pakësoheshn. Nofulla e poshtme filloi të më dridhej duke goditur ritmikiisht dhëmbët e nofullës së sipërme. Notoja linos, recs, garadeus... majtas, djathtas, përpara. Vullneti s'më kishte lënë, kur parandjenja më mbante në atë zonë, që binte zgjatimi i korsisë së gjurmëve. Muzgu rëndohej, të ftohtit rritej, lodhja shtoej. Po sikur zemra,... të më kapnin ato dhimbje aq të forta? Ta ndërprisja misionin? Po frika për jetën? E megjithatë, parandjenja,... një zë i brendshëm më thoshte: "Kërko, aty, kërko". Më bëhej zëri i babait të fatiut: Sotiri! O josmu ine mesa. (Sotir! Biri im është brenda).

Teksa lëvizja duart dhe këmbën e djathtë, preka një send,... Pa arritur të perceptoj frikën apo shpresën, dështimin apo suksesin, humbjen apo fitoren, këmba e majtë tek shtynte ujin poshtë goditi fort mbi një gjë të fortë si hekur, me të pestë gishtërinjtë nga kurrizi i falangjeve. U gëzova. Fuqitë sikur më riktheheshin. Inteligjenca e palodhur punonte ethshëm. E vetmja që s'më braktisi. Fillova të vërtitem rreth enigmës, të papriturës. Të ishte traktori?!... U zhyta kokëposhtë e humba nën ujë. E mbajta frymën goxha. Në kërkim me hamendësi se asgjë sshikohej, kisha hapur një tubo të gjerë, e cila ishte fiksuar fort. U përpoqa ta shkulja dhe ta nxirrja mbi ujë, por më kot, ajo

nuk luante vendit. U zhyta më thellë, më thellë, dhe,... rreth një metër më poshtë, në bazën e saj, preka me duar një shesh metalik. Traktori thashë me vete. U rrotullova sakaq me kokë lart dhe u gjenda në këmbë mbi tavanin e hekurt. Rrija mbi traktor në majën e gishtave. Ngrita dorën lart dhe bërtita: e gjetaaa. Pastaj thirra përsëri: jam mbi traktor. Amfiteatri i murrmë gumëzhiu. Gratë filluan kujën qanin me ulërime. Mugëtira gjëmonte, siç gjëmon zëri në grykën e pusit. Qindra xixëllonja vezullonin në atë acar fshikullues. Ishin cigaret e burrave që heshtnin, bisedonin, hamendësonin. U çlirova. U gëzova e mund të them u lumturova. Gjithë ajo sakrificë mu shpërblye. Mezi e kuptova së çfarë ishte ai tubi i gjerë rreth 80 cm. Skapamentua. Sa e sa traktorë kisha parë nëpër ara tek punonin e tymin e nxirnin nga skapamentua. Zetorët apo traktorët, mezi ndizen prej lagështirës apo lagies së kandelës. Rrathët me tym të zi pëlcastin nga skapamentua e një traktori apo zetori të bukosur e në dimër dallohen fare qart, tek ngjiten lart, duke u zmadhuar, njëri pas tjetrit. Këto imitojne djelmoshat që lozin me cigare, e me buzë të mbledhura, shtyjnë rrathë tymi.

Ashtu në një gjysmë i ngrirë, me tubanet e këmbëve poshtë, mbi kabinë, mbahesha fort pas skapamentos. Lindi shpresa. Po traktoristi? Të kishte ngelur brenda në traktor, apo të ishte diku, jashtë kufirit?!... Sa u fitua një betejë, duhej zhvilluar tjetra.

\* \* \*

Ku është traktoristi? Gjithë ajo gumëzhitje njerëzish u shua. Heshtja pllakosi përsëri. Nata kishte rënë sterrë e zeze. Zemra rezistoi pa pushuar, po arsyeja më thoshte: sa më shpejtë të dalësh në breg. Truri llogariti forcat e humbura gjatë ditës, tronditjen, të ftohtit, ankthet, rreziqet e më urdhëroi të dalë në breg. Atëherë nuk kishte celularë e motoskafë, që të lehtësonin punën. Isha një polombarë me veshje lakuriqësinë siç më kishte bërë nëna. Urdhërat mi jepte truri tim. Asnjë nga turma nuk dëshironte humbjen e jetës time. Asnjë nga bregu i skëterës nuk mund të më ndihmonte. Të ishte ndonjë mjeshtër i madh, do të ndryshonte puna.

Gjithë shqisat e mija i kisha vënë në gadishmëri të lartë, po vetëm me anën e të prekurit përgjysmova enigmën, e kjo falë gjurmëve të ngrira që po të ishte ndryshe, do t'ishin prishur nga ecejaket e panumërta. Urdhëri ishte dhënë, po një zë tjetër e kundërshtoi. Vendosa të zhytem për të sqaruar gjysmën tjetër të enigmës: ku është traktoristi?!

U zhyta kokëpshtë, rreth dy metra nën sipërfaqen e ujit që më vinte deri te mjekra. Tëntoja të gjeja derën e traktorit. Terri më sajoi lojën kukafshehtas. Sytë m'i kishte mbyllur si me shami. Në kërkim preka dorezën e derës, u përqëndrova, e rrotullova, por nuk e ktheva dot. Ajo nuk lëvizti. Ndërkohë fryma mu pakësua, Të ftohtit e madh, ma uli mbajtjen e gjatë të frymës. Frika më sabotonte. Frika

që do të prekësh një të vdekur që nuk e sheh me sy, është shumë e madhe. Sado përvojë të kesh, nuk fitohet kollaj "imuniteti". Edhe më zemërguri, kur zhytet për të nxjerrë një kufomë ka emocione negative. Çast fantazmagorik, sikur i mbyturi do të zgjatë duart dhe do të kapë. Është ajo psikozë e krijuar nga e vërteta që thuhet: "I mbyturi të mbyt". I mbyturi vërtet të mbyt, po në çastin që po jep shpirt. Kërkon me ngulm të kapet diku, e kështu kap e mbyt shpëtimtarin, duke i bllokuar duart, frymëmarrjen, apo këmbët. Më ka ndodhur me një të porsambytur në Përmet. Ishte polic. E rrëmbeu Vjosa. Në çastin që më mbërtheu, e godita me grusht në hundë dhe më liroi. Së bashku me shokun tim Gjon Baldinin, e kapëm nga krahët, pas shpinës së tij, duke e shtyrë përpara drejt bregut, e duke e ngritur lart mbi ujë kokën e tij. Njeriu në ujë peshon 4 kg. e gjysmë, deri në 6 kg., aq sa peshon koka dhe ajo dorë që ndodhet mbi ujë. Pesha e trupit e zhytur në ujë, nuk peshon aspak.

Fryma po më mbaronte. Kërceva mbi ujë para se të mbytesha, duke harxhuar dhe grahmën e dytë të ajrit rezervë, që e mbaja për ndonjë vonesë të mëvonshme e që duhej për të shpëtuar jetën. Më ka ndodhur diku, në çastin e daljes një ngecje, një ngërç i muskujve, një marrje mendsh.

Njëherë, biri im i vogël, Arturi, ngeci në një guvë të vogël. Hyri dhe nuk dilte dot. Mbajtja gjatë e frymës e shpëtoi.

Me të dalë mbi ujë, u kapa pas skapamentos. Merrja frymë me sforco. Rreth tre minuta ndenja duke marrë frymë, deri sa u normalizova. Truri e kishte dhënë urdhërin të prerë. Kufijt nuk mund të kapërceheshin. Kush isha? Një hero që bëja aventura, apo një aventurier që doja të bëja heroizma?

S'kisha dëshirë të më pagëzonte vdekja. Nata me penelin e saj, e kishte nxirë krejt tabllonë përqark. Binte një shi i hollë me suferinë e llohë bore. Në mes të liqenit, mbi traktorin e mbytur, më dukej vetja i vetëm, i vogël, i brishtë, i pafuqishëm, përballë asaj natyre të egër, me atë ujë pis të zi. Në mjegullën e natës, liqeni sterronte e dukej dhe më i llahtarshëm. Një zë i nënujshëm më bëhej se gjëmonte: "Raq Paskaaal! E ke pisk të matesh me mua." Vendosa: do të vi nesër, pret puna,... Mos është gjallë e të përpiqem për ta shpëtuar. Ka plot pesë ditë i mbytur. Kush e di si është nxirë e transformuar. Nesër, nesër do të vi, vendosa dhe,... ngela një hop, pa kryer veprimin. Inteligjenca më ndaloi. Nesër, ... po nesër nga do ta fillosh o njeri. Përvoja e stërvitjeve ushtarake më kujtuan orientuesit. Mendja më shkoi tek një dru i gjatë ta ngulja në skapamento. Po ku ta gjeja. Isha rreth njëqind metra larg bregut. Me se të ma hidhnin? Me se të ma binin? Hodha sytë nga bregu, e i ngula në dy silueta pemësh karakteristike. Në një vijë me atë, dy orientues të palëvizshëm, gjendet traktori, thashë me vete. E fiksova këtë drejtim, e në drejtim të orientuesëve, kërceva mbi ujë me not të shpejt drejt bregut. Më dukej sikur Liqeni i Vdekjes po më thithte ne brendësinë e tij, sikur një dorë e padukshme, po më kapte prej këmbëve e po më tërhiqte poshtë. Përsëri, si nga nënuji, më bëhej një zë që gjëmonte: "Raq Paskaaal! E ke pisk të matesh me mua!" Ndoshta ishte lodhja, të ftohtit, nata, frika, rreziku, prania e vdekjes. Dola në breg, sipas taktikës së parë, iu afrova orientuesëve për të fiksuar dhe më mirë, ktheva kokën nga liqeni e instiktivisht pëshpërita: Vrasës!

\* \* \*

Renda buzë liqenit, e shkova te xhipsi ku ishin rrobat e mija. Isha tërë llucë. Kërkova një kovë me ujë. Disa njerëz me sollën në çast, ujë, sapun, peshqir. Lava këmbët, duart, fytyrën, me aq sa munda n'errësirën që kishte pllakosur. Dridhesha, po nuk e jipja veten. Le që askush nuk ma shikonte fytyrën. Vetëm dritat e makinave ndriçonin. Pjesa dërmuese e njerëzve ishte larguar, duke aluduar secili sipas mendjes së vet. U fshiva shpejt e shpejt dhe u veshja. Dikush më tha të hypja te makina e kryetarit te degës.

Pesë makinat e degës, me gjithë ato të SMT-së, u nisën për udhë, duke zbritur më poshtë rrëzës së malit, në drejtim të qytetit. Kryetari i degës, më shtrëngoi dorën e me tha: “Te lumtë Sotir, na nderove në sy të popullit! E gjete traktorin në mes të liqenit.” Ishte ulur përpara në të djathtë të shoferit, po kokën e kthente prapa, duke më folur mua, e duke biseduar me shokët e tij oficera. “Do të vish dhe nesër, mbase e gjen kufomën”, - u shpreh me shumë mirësjellje kryetari. Patjetër do të vi. Nuk do ta lë punën në mes, u shpreha unë me bindje, unë që para pak ditësh isha tmerruar nga dhimbje të forta të zemrës. Po zemra ishte bërë si përherë e fortë dhe mua më bëri jashtëzakonisht të fortë. Shikoni në ushtri për ndonjë gomone, vazhdova bashkëbisedimin. Janë të domosdoshme, mjetet ndihmëse. Në botë ka polombarë dhe kostume të ngrohta për zhytësit. Kështu shkurtohet koha, evitohen rreziqet, dhe energjia nuk

harxhohet për të përballuar acarin e ccejaket me not. Në rast se do të kishim një varkë, afroheshin një grup njerëzish, në kërkim të traktorit. Të gjithë shikimin e kishin përpara tek asfalti, që shkëlqente nga shiu dhe dritat e forta, po veshët i kishin ngritur dhe dëgjonin çdo detaj. “Për këtë ke të drejtë”, - më tha kryetari. - dhe më pas shtoi: “Kemi katër ditë që presim polombarët nga Saranda, por ende s’kanë ardhur”. Bisedat u ndërprejnë. Secili ra në mendimet e veta. Dëgjohej vetëm motorri dhe zhurma e rrotave, që hidhte anash ujrat, dhe copërinat e akullit që kërciste, kur thyhej si qelq. Po fshirsja e xhamave na vuri në gjumë, me atë fësh - fëshen e saj, teksa largonte ujët e shiut, që dukej sikur s’do të pushonte kurrë.

Rruga zgjati goxha. Në postobllok, makina uli shpejtë-sinë dhe ndali. “Do të zbresësh e do të hipësh te makina e shefit të krimeve, që e ka shtëpinë afër jush,” - u dëgjua zëri i kryetarit, që në atë kohë, na shkundi dremitjen. Zgjati dorën me një buzëqeshje të çiltër duke më uruar natën e mirë. Përshëndeta të gjithë ngrohtësisht, zbrita e u drejtova tek makina që do të më çonte në folezën time.

\* \* \*

“Erdhi babi, erdhi babi”,... dëgjohehin cicërimat e zoçkave të mi që më rrethuan. Frida mu hodh në qafë e qante pa zë. Unë e shtrëngova në gjoks, bashkë me kalamaj-



-të që më kishin pështjellë. O ngrohtësi e strehëzës sime përdhese. Pasi hoqa peliçen, patinat, u struka në minderin pranë sobës. Arturi, i vuri dru sobës, pa i thënë kush. Bëri një zjarr bubulak për shtat palë qejfe. I hoqi fare rrathët sobës, e flaka u sul mbi të. Të gjithë qeshëm e u kënaqëm me flakërimën që merrnin fytyrat tona, nga gju- -hët dhe afshi i zjarrit. Ja erdha te strofkulla e nëndheshme me lagështirë. Gjithë ata njerëz me përgjegjësi e ata oficerë rehatoheshin tani në hyrje të bollshme Më dhanë edhe mua zgjerim në listë, po se kush pështyu, se kush e përpiu. Unë coptohesha: një për të gjithë. Shteti që përfaqësonte të gjithë i kishte kthyer shpinën njeriut... S'isha vigan që të shpupuritesha për të habitur njerëzit. Një njeri që kurkujt s'i kam bërë keq. Tërë jetën jam prirur nga e mira dhe kam bërë pambarim të mira.

Isha i lodhur, Disa orë në ujrat e ngrira, një banjë e akullt në Liqenin e Vdekjes, më sollën gjumin. Që në makinë mu mbyllën sytë, pa le aty në atë qoshk, i ngrohur nga dashuria e familjes e flakët e zjarrit. U mbështeta tek jastëku dhe humba në gjumë.

Ashtu i humbur, ndjeva tek më puthnin kalamajtë e më nduknin nga hunda që të zgjohesha. "Raq! Çohu të hash bukë. Sofra është gati" - dëgjova si në ëndërr zërin lutës të Fridës, e ndjeva një puthje në buzë. U ngrita me sy të mbyllur, e me kokë të varur në gjoks. Fillova të ha me përtesë, pak gjellë me patate salcë, pa mish. Duke ngrënë mu hap oreksi. Mbushe dhe një herë pjatën, i thashë Fridës. Hanim patate me bukë të thekur. Si mos kënaqeshim. Bukën e thekte Arturi, që jepte shenja se do të bëhej njeri praktik. Po rriteshin fëmijët, rriteshim në moshë e në mendim dhe

unë e Frida.

Përgjumja më doli fare, tek mu kujtuan qentë e kufirit që pashë te liqeni. Qen ujk austriak e gjermanë. “Volpe - Lupo”, të zgjuar si dhelpira. Ishin të shëndoshë e të mëdhenj. Ushqeheshin mirë me mish kutie. Ne njerëzit hanim patate pa mish. Më kaploi një ndjenjë, një meditim... nuk vlen njeriu as sa qentë?!...

I njihja mirë qentë e kufirit. Kam shpëtuar disa prej tyre. Mi kishin sjellë kufitarët e Kakavijës. Një qen, e kishin goditur keq në kokë, direkt në gjendrën parotide. Glandula Parotis, është e vendosur në Angulus Mandibulare, në këndin e mandibulës së nofullës së poshtme. Plumbi kishte ngecur në kockën ku bashkohet maksilla, nofulla e sipërme me atë të poshtmen, në Procesus stiloideus, dhe kishte thyer tuberkulum mandibulare.

Gjendra parotis, është mbrapa veshit dhe prodhon pështymën, duke e nxjerë në gojë, mbi dhëmballën e tretë nëpërmjet duktus stenon (kanalit stenon). Gjendrat submandibulae me sekrecionet e tyre me ptialinë e tjerë, që tretin ushqimin, e lagin gojën, me derdhjet nëpërmjet kanalit varton.

“Ç’ke që e humbe pusullën? Ç’po mendon kështu”? më pyeti Frida, tek më pa që ndalova përtypjen dhe ngula vështrimin tek një pikë në mur. “Asgjë, asgjë. Mu kujtua një qen që e operova në gjendrën e pështymës Parotis. Kam bërë punë titanike, pa shpërblim. Çuditëmi që ushqehemi kaq keq”. Pashë nga zjarri drutë që po mbaroheshin. “Jemi në mesin e dimrit dhe ç’do bëjmë për dru”? - pyeta Fridën. “Do të blejmë. Më ka dhënë një shoqe dy triska. Po më thuaj si qe puna? Po pyes për të dytën herë”, - më tha ajo

kur po qetësonim stomakun. “Traktorin mezi e gjeta. Ishte zhytyr në mes të liqenit. Duke ecur mbrapsht për të marrë baltën përpara, në zgjerim të liqenit, siç duket, i janë lagur frenat, e ashtu mbrapsh u fundos deri në mes të liqenit. “Po traktioristin e gjete”? - më tha ajo. “Jo, jo, i thashë, nuk e hapa dot kabinën. Nesër në bēfshim gjë. Duhet vërtetuar nëse është i mbytur në kabinë, i mbytur diku, ose “i arratisur”. Shpjegoja thjesht, atë gjë tejet, tejet të vështirë. “Shtroju kalamajve e hajt të flemë”. U çova i pari e rashë në gjumë si i vdekur.

## Zhgënjim dhe ngadhënjim.

Në ora shtatë erdhi shoferi i degës, një burrë i sjellshëm bjond, pikalosh. Trokiti lehtë në derë. Unë e kuptova kush më kërkonte. Hapa derën dhe e përshëndeta. Erdha, erdha, i thashë. Përqafova Fridën, dhe ika së bashku me shoferin. Zbritëm shkallët, korridorin e gjatë e dolëm nëpër baltë rrotull teqesë, nëpër varrezat e dikurshme, e nëpër shi u futëm në makinën e degës. Përpara rrinte shefi i krimeve. Ishte minoritar. U përshëndetëm.

Vargu i makinave, ashtu sikurse dje, nisën vrapimin drejt liqenit. E njëjta panoramë, dhe më e rënduar. Makinat uturinin, ngaqë mezi çanin erën që frynte me furi. Shiu, lloha e borës, ishin shtuar. Në të djathtë, Mali i Gjerë, i ngarkuar me borë e mjegull, i çarë si me shpatë nga përrenjtë e thellë, që ndajnë njëkohësisht me rradhë, fshatrat e krahinës. Gjithkush ra në mendime e veta.

Unë isha bërë i fortë si më parë. Dje kalova një sprovë tejet të vështirë dhe arrita të përgjysmoj enigmën. Oficerët, ndjenin një lloj përgjegjësie detyre e nëse puna del ndryshe,

do t'u hiqej dhe veshi. Po në këtë mes, ishin spektatorë të thjeshtë, pa thirrur e brohoritur atje në amfiteatrin e kobshëm. Të përgatitur e të kalitur ishin e të stërvitur, po ja që mua s'mu bë njeri shok, për të zgjidhur enigmën që në fund të fundit, kishte të bënte me detyrën e tyre. Isha si para një provimi të dytë, e teksa shikoja tablotë e dimrit të egër, shkoja ndërmend se ç'kisha bërë, e ç'duhej për të bërë.

Kur makinat me gulçim ngjitën dredhat e të së përpjetës, e iu afruan Liqenit të Vdekjes, pamë njerëz të rradhitur si në ata filmat, ku indianët e Amerikës, dalin mbi kuaj, në maja kodrash me prijësin e tyre. Rrinin të mbledhur, të ngurtësuar, në këmbë, duke duruar shiun e imët që binte me një thëllim therrës. Edhe këta, sikundër oficerët sikundër dje, të pështjellë në punën e tyre prisnin "heroin e përrallave", që do sfidonte përsëri acarin, rrezikun, vdekjen. Të tërë bënë çudi, po asnjë s'kishte dalë vullnetarisht për shpleksjen e asaj që kishte ngelur e fshehtë.

Kur zbritëm nga makina, mua mu krijua përshtypja e një situatë tjetër. Ishte hapur tubi i shkarkimit. Një motopompë thithte ujët dhe e hidhte matanë digës. Po kjo punë më dukej sikur me një gotë çaji të boshatisje një pusë të thellë. Prurja ishte më e madhe se derdhja. Të gjitha rrjedhjet e rrëhet e Malit të Shtugarës, si dhe përroi i Polovinës, i tokave të manastirit, të Shën Mëhillit, ose siç quhet ndyshe Aksharhis, zbritnin me nxitim e mërmërimë, në liqen, bashkoheshin, ndalnin vrapin e binin në qetësi.

Supriza ishin polombarët. Kishin ardhur dy sarandiot. I kishte sjellë SMT-ja, kundrejt një pagese të majme. Një zhy-

-tje, shpërblehej me 50 000 lekë, kur rroga mujore e një inxhinieri, ishte 7 - 8 mijë lekë. Një pështjellim ne vetvete. Të kishin ardhur 4 - 5 ditë përpara ishte krejt ndryshe, kurse tani... U trishtova. Në vetvete filloi një duel. Shpirtmiri më thoshte: Raq! Ç'ke, pse ligështohesh? Gëzohu dhe ti me të tjerët. Dje u ropate duke rrezikuar jetën, zgjidhe gjysmën e enigmës. Ishte një sakrificë që s'doli ta bënte askush. Ji krenar për këtë. Edhe stërmundimi yt do të vlerësohet. E rëndësishme është, e vërteta të dali mbi liqen e të binden ata qindra e qindra njerëz që presin në ankth, duke duruar kapriçot e vrazhdësinë e këtij dimri të ashpër.

Ai tjetri më thoshte: "Raaq! U dërmove. Vure kokën peng në duart e vdekjes, me duart e tua. E përse? Kush ta di? Luftove një mbasdite të tërë me vdekjen, deri në muzgun e thellë. Dhe fundi, ku është i vdekuri? Ç'qe ajo këmbëngulje? Mos doje të mbeteshe dhe ti brenda? Beteja pa lavdi. Ja ku erdhën trimoshat, shpëtimtarët e vërtetë, shpresa e madhe, e thuajse e kanë gati punën. Ty kush do të kujtojë, ty kush ta di. U hoqe hero i përrallave, po tani të duket vetja sa Gishtoja, një kacimic që s'kujtohet kush. E djeshmja kujtohet e sotmja jetohet. Po tani askush s'e kujton të djeshmen tënde. Tani njerëzit presin atë që kanë kaq ditë që e presin. Ah, Raq, Raq, i krisur, i marrë, që rrezikove e s'arrite suksesin. Tani struku e shiko si do t'i kryejnë shpejt e shpejt punët polombarët. Sytë e gjithë njerëzve janë mbërthyer tek ata, urimet e zemrave janë për ata, falenderimet për ata, shpërblimet për ata, lavdia për ata. Ç'tu desh. Nuk e di si është humbja? Në çastin kur fitoren e ke kapur si një zog, e s'i gëzohesh dot, sa hap duart ashtu i ngazëllyer, e paksa i shkujdesur, fitorja të fluturon, ikën

zogu nga duart, ikën në hapësirë e s'kthehet kurrë më. Ti mbetësh i shtangët, i brengosur, i inatosur me veten. E humbe, Raq e humbe”.

E përsëri ai zëri shpirtmirë: “O i mirë! Rri, s'ka gjë. Ti bëre atë që munde të bëje, edhe të pamundurën, atë që s'doli ta bënte kush. Edhe ti ke pjesën tënde te sukcesi. Mos u trishto, mos u dridh, mos e dëgjo zërin e ziliqarit. Raaq!”

Me shumë e shumë njerëz, këmbeja përshëndetje te përzemërta. Ndërpreva duelin, dëbova zërin e egos, e ndjehesha më i qetë në vetvete, duke pritur se ç'do të ndodhte më tej.

\* \* \*

Polombarët përgatiteshin. Njëri veshi kostumin e polombarit mbi robot civile. Ishte aty te të dyzetepesat, kokëpakrehur, jakëpalarë. Tjetri i vendoste skafandrën. Po ia vidhose te qafa e kominoshes prej llastiku. Ustai i bëri shenjë çirakut t'ia hiqte përsëri. Sapo hoqi skafandrën ustai shpërtheu: “Si ma vendose kështu, o të ... udhët” Të pranishmit shikuan në sy njëri - tjetrin. Tjetri, ia ktheu edhe më keq, ia vendosi përsëri, ia vidhosi, ia shtrëngoi me ganxha, dhe i veshi patinat prej plumbi. Në gjoks i vari peshat prej plumbi. Skafandra, përpara nofuallave, kishte tubin e gjatë si puna e kundragazit. Tubi ishte i rrotulluar

në një cilindër, rreth 80 cm, të lartë si puna e telefonit, që mban në çikrik reparti i ndërlidhjes. Tubi lidhej me një pompë të madhe. I dyti filloi t'i jepte pistonit me duar. Hërra e parë që pashë në jetë, sesi ajrin ia jepte shoku me pompë, nëpërmjet tubit unazor fleksibël, si trakeja që çon ajrin nga hunda në birfurkacionin polmonar. Aparatura m'u duk e thjeshtë (ordinere), si ato që janë përdorur në Lumin e Senës në Paris më 1800, për të pastruar shtratin e ndotur. Zhytësi s'kishte telefon. Ngrinte më kot dorën anash. Kostumi ishte i pamanovrueshëm. I futur në të bëhej i rëndë trung që mezi lëviste, si i futur në allçi.

Polombari u nis më këmbë dhe sa u largua dhjetë metra nga bregu, ngeci në llucë. Me gjithë ato hekura të rënda e pllaka plumbi, e dija që ashtu do ta pësonte. Menjëherë kërkoi ndihmë nga tre - katër burra, e tërhoqën nga litari drejt bregut. U kthye pa hyrë akoma në liqen, hoqi kostumin dhe nën ambrellën që ia mbanin fshatarët, ndezi një cigare. "Është vështirë, ... s'kemi gjë në vijë" - tha si i menduar, dhe këputi një të sharë nga ato që rrallë i dëgjon veshi. Unë rrija me të tjerët, po s'bija në sy. Vështrimet kishin fokusuar vetëm shpëtimtarët. E djeshmja kishte mbetur shumë larg, e pështjellë dhe e harruar në atë mjegull të dendur dimri inatçi. Halli ishte ç'do të bëhej sot, e jo ç'u bë dje. Po fati sikur s'po ndrinte.

"Po futem unë". - Tha tjetri. U vesh me ngadalë. Si u bë gati u drejtua për nga liqeni. Kuptoi rrezikun që ktheu të parin e u fut në liqen. U sorollat mbi ujë e nën ujë. Minutazhi punonte. Mesoburri i jipte pompës së ajrit në buzët e akullta të liqenit. Polombari kërkonte në vorbullën e zezë të liqenit, kërkonte majtas, djathtas, kërkonte, dhe, ... dha



sinjalin e tërheqjes. S'u gjend dot traktori.. Ç'e përpiu? Dje unë brita si Arkimedi : "E gjetaaaa! Dhashë e mora në atë arenë mizore po s'hapa dot derën. Sot shpëtimtarët s'gjetën dot as traktorin.

Fshatarët tërhoqën litarin dhe si barkas mbi ujë vinte drejt nesh, si kozmonaut, i hapësirave ndërplanetare, nën-ujore të liqenit kryeneç. Për kërkime nënujore, sot përdoren kostume të hollë, të ngrohtë. Kokoret janë fine, të pjesshme, madje të pajisura me telefon përpara gojës, me lëndë që mban e mbron syzet nga avujt. Lopatat në këmbë të zhytësit, që lozin rol parimor, janë tepër të manovrueshme, Dy bombolat e oksigjenit, zhytësi i mban të lidhura në shpinë. Zhytja bëhet vet i dytë, ose grupe të shoqëruar me anije të sofistikuar.

Polombari hoqi skafandrën dhe u zhvesh. Seç manovroi atë kohë duke u zhveshur e tha: "nuk futem më". "Atëherë më lejoni të futem", - iu luta unë. "Jo or jo". - Kundërshtoi mesoburri. Jam notar, ngula këmbë. "Duhet të kesh patentë", - tha rëndë ai. Vërtetë që këtë gjë nuk e dija, u përgjigja si me naivitet. "Do bythë viçi kjo punë, - tha tjetri duke tundur kokën - Nuk është kollaj". Shkonte nëpër duar kostumin duke kontrolluar, e papritur bërtiti sa kishte në kokë: "është çarë kostumii,... Ja vrima. Nuk futemi dot më". Oficerët e degës zgjatën kokat e shikonin kostumin e grisur. E kuptuan e u mërzhitën nga proçka e vrimës, që ishte bërë në atë goxha llastikë të trashë të pajisjes. "Ta ngjitim" - tha kryetari i degës. "Ohuu, sa punë ka ajo... Duhet të vemi në Sarandë, ta ngjitim, e të vimë nesër o pasnesër, - tha më i riu". "Le që vdiqëm nga të ftohtët", - tha i pari.

Shpresa u venit e ishte duke u shuar. Njerëzit u bënë edhe më të murmë, edhe më të ftohtë nga ç'ishin. Nevoja e kthen syrin përsëri tek ajo që u harrua aq shpejt, tek e djeshmja.

\* \* \*

Më afrohet një person i njohur. Ishte kuqalosh. Angjelo e quanin. Kishte studiuar për agronomi. Ishte dy vjet pas meje. E mbaja mend si tifozi tim në peshngritje. Qeshte e brohoriste, kur unë ngrija 30 - 40 herë me një dorë hekurin e vagonave. Sot po qante para meje. Më dha dorën e më puthi. "Tani mbërita nga Lushnja, e kam xhaxha të mbyturin".

"Ku punon? - e pyeta unë".

"Kam punuar në Fermën e Savrës. Tani punoj në seksionin e bujqësisë" - tha ai. Unë e dëgjoja, por sytë i mbaja nga liqeni. Binte shi i imët. Motopompa gjëmonte, po liqeni as që donte t'ia dinte. "Xhek je, Xhek, - më tha Angjelo. Si u fute në liqenin e akullt dje gjithë pasdrekën? Ishim në merak të madh. Po sikur të të pushonte zemra. - Pastaj nxori nga xhepi një tufë mijëshe. - Merri këto. Ndoshta të takojnë edhe më shumë. Rrezikove jetën". Unë hodha sytë te paratë. Ishin goxha. Pastaj e shikova Angjelon në sy, duke e lënë me dorë të shtrirë përpara. Ju faleminderit Angjelo, i thashë. Unë nuk u zhyta për para. Jam njeri me

ndjenja. E bëra sepse ndjenja në vetvete që duhej bërë. Enigma duhet sqaruar. Prindërit duhet të shikojnë djalin e tyre për herë të fundit. Ai futi paratë në xhepin e vet e më tha: "Je njeri i madh, Xhek". Unë, s'kisha kohë për biseda. Më fal Angjelo, i thashë, nuk më mban vendi dhe u drejtova për nga xhipsi.

\* \* \*

U zhvesha me shpejtësi, dhe ashtu me mbathjet e banjës, po ecja mbi akullin e copëzuar e të përzier me llucë, të shkelur qindra herë nga njerëzit, që vërtiteshin rreth e rrotull liqenit të pajetë që kishte marrë një jetë njeriu. Tër-heqja, manovra, a dështimi ta thuash i polombarëve, nuk la fare shije të mirë. "Do të jenë hamenjt të portit" - tha dikush. Zëra nga më të ndryshmit, po kush kishte kohë t'i dëgjonte dhe a ia vlente?!

Puna s'priste. Duhej vepruar shpejt, sakt, dhe vendosmërisht. Duhej nisur pikërisht atje ku e përcaktova. Me lëvizje gjimnastikore arrita në start. Të ftohtit ishte edhe më i madh. Falë stërvitjes time tejet intensive, që më dha qëndrueshmërinë ndaj ashpërsisë së motit, që më dha vendosmërinë dhe një bindje e thellë e brendëshme, që mposht ngurimin, dyshimet, frikën, që përballoja atë sulm të pareshtur të acarit, me erën, me llohën, me ujin e akullt përzier me baltë që bëhej edhe më i akullt. Zemrën s'e kuj-

-tova; dhembja s'më kujtonte e kurrë nuk dëshiroja të më kujtonte. Po siç duket isha bërë një hero i mitologjisë reale të asaj dite të mugët dimri, isha bërë si përherë me zemër. Heshtja e qindra e qindra njerëzve, dhe urimet dhe përshëndetjet e ngrohta fjalëpak, dhe përkujdjet e tyre për mua, merak i tyre, shqetësimi i tyre se mos pësoja gjë, të gjitha më jipnin zemër. E pra, filloi seria e dytë e filmit pa regjizorë, pa kameramanë, vetëm me një protagonist dhe qindra figurantë. Seriali e parë u zhvillua dje. Polombarët shpresëmëdhenj, u harruan më keq se unë para tyre. Kjo punë shkoi si një ndeshje pingpongu, ku njerëzit kthejnë kokën majtas - djathtas, nga sportisti që godet me raketë.

Kur shkova në pozicionin fillestar, një zë buçiti aty pranë: "Delfin, delfin". Eh njerëzit. "Ç" nuk ndiejnë. Sa e çuditshme është bota emocionale. Isha i stërvitur e kisha dëgjuar plot e plot syresh. Sidoqoftë, ajo thirrje zemre më ngrohu, po s'kisha kohë të përshëndesja, se isha zënë terrësisht me misionin që duhej kryer. E misioni, ishte beteja ku duhej luftuar rreptë, e duhej dalë me sukses. Trimëria për zgjuarsinë gjithmonë më është dukur një kokëkrisuri që përfundon në disfatë, në budallalëk. Ndërmend më vinin fjalët e përplotura të babait të mjerë të traktoristit: "Sotiri! Mesa, mesa ine e josmu. (Sotiri! Brenda, brenda është biri im).

U hodha një vështrim të saktë dy pemëve, të cilat, një natë më parë i kisha përcaktuar si orientues të paluejtshëm. Një gorricë dhe një pishë hollushe, i vura në një vijë me veten, me shpinë nga liqeni. Parimi i pushkës: bebëz, thep, shtjegëz. Njerëzit kujtonin se po falesha. U ktheva, 180°, me fytyrë nga liqeni, u shtriva mbi ujën e cekët dhe

notova pa ngecur në Ilucë. Aftësitë e mia si piktor, më ndihmonin të ruaja lëvizjen e drejt e përpara në korsinë imagjinare. Thuhetse 90 - 100 metra nga bregu, dallova diçka që nxinte. Ishte skapamentua e traktorit. Oh, sa u gëzova! U çova në këmbë mbi traktor. Ujët me vinte te mjekra. Më erdhi një forcë e madhe. Harrova të flohtët, harrova çdo gjë që duhej harruar. U zhyta nën ujë, e u përpoqa të gjeja derën e kabinës. E gjeta, e hapa dorezën, rrotullova, po nuk e hapa dot. U mërzhita, po dridhesha. U shkëputa, e dola mbi kabinë të mbushesha me frymë. Pa e zgjatur, u zhyta në krahun tjetër të traktorit, në anën e djathtë. Nën ujë, vetëtimthi mu kujtuan fjalët e njeriut të mirë, shokut të mirë, inxhinier Fori Tolicës: "Raq! Vangjeli është mbytur. Bëj kujdes se mos mbytesh dhe ti. Mos u fut poshtë rruspës, se më një lëvizje të vogël, mund të të zëjë nën vete". Kërkova dhe gjeta dorezën, e rrotullova dhe e hapa. U futa në kabinë, kolltuqet notonin. Preka dorën e kufomës. E tërhoqa në drejtim të daljes, po ajo ngeci diku, në levat e mashave. Këmbët i kisha lënë jashtë derës. Shpesh herë traktoristët përdomin një dorezë, dhe atë e mirmin me vete, për të siguruar kabinën mbyllur. Edhe këtë e mendova, ku i dihej dera, për një arsye të panjohur e të paparashikuar. Mbetesha brenda dhe,...

Frymën e lëshoja me pikatore, me fluska të vockla. U tërhoqa mbrapsht, e u futa në brendësinë e krahut tjetër, nga dera që s'hapej. Kabina që e madhe, e humba në brendësi të saj. Nxora dy ndënjëset që më pengonin dhe tërhoqa kufomën. Ajo më ngeci te dera, dhe e lëshova jashtë derës në liqen, ashtu të ngecur. Shok s'kisha për ndihmë, mjete s'kisha, kostumi i polumbarëve, që "çarë", polumba-

-rëve nuk ua mbante të futeshin të zhveshur dhe, urgjent u ngjita lart, se mu zu fryma. Sa morra pak veten thirra: "e gjeta. Këtu është. Sillni varkën dhe një çengel". Siç e biseduam dje, ishin marrë disa masa, u mendua dhe u sigurua varka, në momentin e fundit fare, kur unë kisha kryer punë.

Zëri im çau kupolën e rëndë të ankthit, e të kobshme që rëndonte mbi të gjithë. Enigma u zgjidh. Versionet e hamendësit u zhdukën nga faqja e dheut. U lërimat gjëmuan mbi Liqenin e Vdekjes me një kujë që të coptonte zemrën.

Varka rrëshqiti në drejtimin tim me tre njerëz brenda. U afrua, mandej hodhën çengelin, ndën derën e djathtë. Çengeli, kapi peliçen e zezë të të mbyturit. Tre fshatarët, e ngritën lart, e morën në duar kufomën e shokut të tyre, e me vështirësi e vendosën në varkë. U dhanë lopatave drejt bregut nga ku ushtonin ulërimat e përvajshme. Nuk mund të rrija me të mbyturin.. U hodha prej kabinës me krol të shpejt dhe dola në anë. Instiktivisht ktheva kokën nga liqeni e mbeta një hop. Në mugëtirën e asaj dite të zezë dimri, Liqeni i Vdekjes, më dukej si një gojë përbindëshi që kishte ngelur pa gojë, e që në momentin kur po dilja, më dukej sikur më tërhiqte, më tërhiqte, për të më përpirë në thellësi të tij.

\* \* \*

U habita sa shpejt kishte rënë muzgu. Vrapoja për te

xhipsi, po turma më pështolli. Angjelo i pari më puthi, Aleks Llambro, Kryetari i Degës më përqafoi. Oficerë, fshatarë të gjithë më përgëzuan, të gjithë, të gjithë. Po s'mund ta fsheh. Një zë që dilte mbi të tjerët nga turma, ma përkëdheli shpirtin: "Raq Paskal i futi plevitin liqenit e jo liqeni Raq Paskalit". U lava, u fshiva e u vështa shpejt e shpejt e hypa në makinë. Gratë nuk kishin kohë për falenderime. Ato do të përgatitnin kufomën e nxirë e të fryrë, nga qëndrimi i gjastë ditëve në ujë. Fatkeqisht kishte mbetur në pozicionin e ulur me duar e këmbë të përkulura. Nuk mbante erë. Në atë ujë me akull, proceset destruktive të putrifikacionit, zhvillohen ngadalë.

Ende pa u nisur xhipsi, më kërkuan të dal jashtë. Në dritën e prozhektorëve të makinës, pashë babanë e të ndierit. Dola dhe u përqafova. Sytë i kishte të skuqur. Lotët kishin shterur, i qenë tharë. Me buzë të ftohta mezi në pëshpëriti pranë veshit: "Sotiri! Simera tha qimithis sto spiti mas. (Sotir! Sot do të flesh në shtëpinë time). Duke e shtrënguar pas gjoksit tim i thashë: Efskaristo poli patera mu. Ime poli, poli kurasmenos. (Faleminderit shumë babai im. Jam shumë-më, shumë i lodhur). Shefi i degës bëri shenjë për nisje. U ndava nga babai i Vangjelit të shkretë e u futa në makinë. Babai, nëna e të shkretit, motra, gruaja, shokë e miq, bashkëfshatarë, u nisën me të vdekurin, për ta përcjellë të nesërmen në një gropë tjetër. Oficerët e degës, njerëzit e partisë e të pushtetit po ktheheshin me mendje të mbledhur, për tu rehatuar në banesat e bollshme. Ç'shqetësim, sa shumë ishin lodhur, ç'ankth. Thirrja ime: "e gjeta, këtu është" u trasmetua në sinjal që jepej me radio nga shefi i degës, nga dega për ministrinë, nga ministria te partia, në

---

majë të piramidës. Të gjithë këta u qetësuan menjëherë që komunisti nuk ishte aratisur,. Vetëm dhe vetëm kjo kishte rëndësi, dhe vetëm dhe vetëm kjo u duhej. Edhe unë luftëtari triumfator i betejës, i lodhur i raskapitur po kthehesha në strehëzën time të nëndheshme.

\*



## EPILOG

Duhet hequr dorë nga këto rite të vjetra. Gjatë tre vjetëve të qëndrimit në Gjermani, pashë një rast vdekjeje të zonjës së shtëpisë ku banonte Arturi. Asaj i vdiq babai Shaufele. Arturi ishte në Shqipëri ato ditë. Unë dhe Frida shkuam në shtëpi tek e bija me shpresë se e kishte marrë në shtëpi kufomën e të atit që i vdiq në spital. Gizela ishte vetëm me burrin e saj dhe po shikonin televizor, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ne përfytyronim se ia kishin behur të gjithë banorët e Erligheimit dhe për ne nuk do të kishte vende për të zgjatur kokën. Zëmë vend në sallonin e madh në kolltuqet. I shoqi i saj ishte shtrirë në divanin e madh mbi lloj - lloj jastëqesh të buta.

Vain? Ber? Uiski?

“Vas trinksh? (Çfarë do të pini, Verë? Birrë?) Ne preferuam nga një birrë të vogël në shishe.

“Vo ist dajne fader? (Ku është babai yt?)” - e pyetëm ne.

“Në kishë...” - u përgjegj Gizela. - A doni ta shikoni?

“Po, po...” - i thamë.

Na morri në veturë dhe natën në ora 12<sup>oo</sup> shkoi te vëllai i saj moshatar me ne, mori çelësin e kishës, brenda në vorreza. Në një dhomë mbi tavolinë ishte arkivoli prej xhami ku plaku i vdekur dukej sikur po flinte. Frida dhe Gizela derdhën lot për plakun e mirë, Shaufele. Të nesërmen unë shkova në kishë. Ceremonia ishte interesante. Gjithë shoqëria asistoi. Ishte veshur me kostume gra dhe burra, të cilët çdo ditë i shikoja me pantallona të shkurtëra e me kanatjere. Në sallë të gjithë të ulur këndonin me nota, pjesë muzikore të drejtuara nga prifti, i cili i binte pianos Rekuim nga Johan Sebastian Bahu. Në fund e vendosën plakun në gropë, u dhanë duart njerëzve të familjes. Secili hipi në veturën e tij. Nuk kishin pritje e përcjellje ne shtëpi. Vetëm kurorat me lule ia kishin vendosur mbi varr. Pas një viti e sistemuan varrin me mermer dhe mbi kokë vendosën një gur me emrin e tij.

Frida dëgjonte me vëmendje të përqëndruar pëshpëritjet e mia në gjumë. Mu shfaq katedralja e Shën - Pjetrit në Romë. Kubeja ku punonte Mikelanxhelo pikturat pesë vjet rresht. M’u shfaq një tablo e tij. “Toka dhe qielli” dy njerëz që rrinë përkarshi, duke prekur dhe drejtuar gishtat tregues. M’u faneps një fytyrë ë paparë ndonjëherë. Ndofta ishte Nikolla Bernini që ka projektuar katedralen e pjacës së Shën - Pjetrit në Romë...” - më tha zëri i ëngjëllit në vesh.

Frida u fut në shtrat, duke më ngrohur. Ndjeva një fërgëllimë në buzët e mia, kur prekën gjoksin e plotë erë trëndafil të saj. Me sy të përgjumur pashë sesi po gdhihej.

Me një sjellje të ngrohtë dhe të përzemërt, Frida më tha: “Edhe në gjumë je mjeshtër i tregimit. Edhe pse m’i ke thënë disa herë përsëri më pëlqyen”.

Përse flisja? Si u krijua raca e kuajve gjakpastër anglezë, më e shpejta në botë. Kryqëzimi i pelës daneze me hamshorin arab.

Unë buzëqesha tek e pashë me këmishë kineze bojë qielli të qëndisur në gjoks me tantellë të bardhë, e cila i shkonte ngjyrës së mishit të saj ngjyrë fildishi në rozë. Trupi i shëndetshëm dhe tërheqës që lëvizte si gjarpërueshe në shtëpi dhe në shtrat. Ajo dinte të më çmonte edhe pse nuk fitoja shumë para. Këtë e tregonte sjellja e saj e ngrohtë dhe e përzemërt.

“E dashur po të plotësoj ëndrrën dhe me një fjalë tjetër a ke dëshirë të digjosh”? “Çfarë do të më thuash”? - më pyeti ajo

“Kali gjakpastër anglez ka një defiçiensë në distancat 1000 deri në 5000 metra, i del gjak nga hundët.

“Sa keq më vjen për kalin që i rrjedh gjak ...”

“Po, po nga zgjerimi i madh i enëve të gjakut në polmone dhe në regjionin e vrimave të hundës tashmë me flegra të hapura,” - plotësova unë.

“Nuk mund të korrigjohet ky difekt?” - pyeti Frida kureshtare.

“Jo, jo është i pandreqshëm, bëhen kryqëzime të tjera dhe kanë dalë raca të tjera të shpejta dhe me rezistencë të madhe, por për sprinte të shkurtëra gjakpastërti është kampion. Frida kishte një nur dhe një pamje të mrekullueshme tek mbi fytyrën dhe gjoksin e bardhë prej dritareve hyri drita e një agimi me diell.

Rrezet e tij ranë direkt në krevatin tonë prej dritares së vetme që kishim në dhomën e vetme në Hazmurat. Ajo u ngrit dhe tha: “Ç’bukuri mahnitëse! Eja të shikosh. Ka rënë borë dhe kalaja ngjan si monument magjik. Gjithçka e ka mbuluar bora...”

“Më vjen rëndë të çohem... Jam i këputur,” - i thashë unë.

Ajo më puthi, më kapi dorën dhe më tërhoqi me shumë delikatesë dhe me mirësjellje.

Gjendja ime shpirtërore nuk ishte më e drobitur si një natë më parë, por trupi im ishte i drobitur nga qëndrimi i gjatë në ujin e ftohtë të liqenit të zi, të Liqenit të Vdekjes.

“Je njeri i mprehtë dhe i fuqishëm, - tha ajo. - Ti mos e humb këtë pamje, duhet ta hedhësh në telajo”.

“Si the të ngrihem dhe të pikturoj në këtë të ftohtë?”

“Ajo hapi dritaren dhe më tha: “Është 20 janar dhe dita ka marrë 1 orë nga nata. Më 16 janar ne mbushëm 11 vjet martesë. Nuk e festuam, por një tablo e Gjirokastrës me dëborë do të ishte dhurata dhe festimi më i mirë për martesën tonë.

U ngrita dhe thitha ajër të pastër. Dhe janari ka ditë të ngrohta me diell të cilat unë i shfrytëzoja, duke u zhveshur dhe duke bërë banjo dielli.

Merrja tre fëmijët dhe shkonim nga buza e lumit. duke bërë vrap e duke u shpëlarë në ujin e pastërt. Në kthim, binim trungje plepi që lumi i ka shkukur gjatë dimrit. Kështjella muzeale më pëlqeu shumë me shtëpitë përreth të mbuluara me borë dhe Mali i Gjerë që zbardhonte në sfondin blu të qiellit.

Hapa bojërat dhe mbi një karton aty që brenda dhomës

hodha pejsazhin “Gjirokastra në ditë dimri” Veprën e kam ekspozuar sot në “Galerinë Paskal”.

Vepra është punuar me ngjyra vaji 40 cm x 45cm. Frida më solli të pi një gotë me çaj të nxehtë. Luga brenda gotës së qelqit më pëlqeu për të pikturuar një natyrë të qetë, ndërsa Frida mu duk si një hyjneshë në mes të maleve me dëborë si një madonë e Rafaelit, piktor i rilindjes që i vdiq Italisë në moshën 30 vjeçare. Në fund hodha firmën dhe ia dhashë. Fridës i pëlqeu shumë dhurata. Ajo më buzëqeshi me shumë hijeshi dhe lezet tek po rregullonte krevatin ashtu kokëulur, duke lënë padashur zbuluar gjoksin formëbukur si mermeri gdhendur me mjeshtëri nga Rodeni, skulptori francez që i këndoi dashurisë me daltë.

Sapo e pashë me sy këtë pamje u trondita. Fshiva duart me pecetën e ngjyrave dhe putha gruan, duke e shijuar bukurinë e asaj që e rrëmbeva dikur dhe e dua me të njëjtin zjarr intensiv. Akoma i ruan sytë e shkëlqyer dhe fytyrën e pastër, të bardhë, të parrahur nga dielli.

Flokët me onde i binin mbi supet dhe fytyra e trëndafiltë me tone të verdha më jepte përshtypjen e një perandoreshe. Doja ta kundroja më shumë, por ajo lëvizite duke përballuar punët e shumta që ka shtëpia. Ajo shkroi ditarin e vet dhe iku të japë mësim, duke marrë fëmijët me vete. Unë bëra pushim. Nga puna ime kishte marrë leje kryetari i Degës.

Cilësitë e saj më pëlqenin shumë dhe ambjenti ku u rrit qe i mirë. Gjyshja e edukonte shkëlqyeshëm; nëna e saj ishte e urtë, kokëulur dhe babai punëtor, shofer i ndershëm. Tek unë gjeti njeriun kërkues me vullnet, duke u bërë edukatorë të njëri - tjetrit.

Kur iku Frida në punë dhe pse për mua kishin marrë leje në Drejtorinë e Ndërmarrjes së Grumbullimit, unë dola një vizitë nga stallat e lopëve dhe të derrave, në zallin e Teqesë, ku shtrihesh ferma jonë. Erdhi Drejtori me një xhips “sharabajke”, Lame Sheshi energjik. Më përgëzoi:

“Na nderove, Sotiraq!” - më përgëzoi ai dhe tek qeshi iu duk dhëmbi i florinjhtë.

\* \* \*

Në darkë komentonim përshtypjet e ditës. Frida mori dyshekun dhe e shtroi në mes të dhomës sonë. Aty flinte Arturi me ne se e kishim në parket. Në guzhinë flinin mbi minderin me dërrasa Diana e vogël 5 vjeçe dhe Mikeli 3 vjeçar. Tek po ngroheshim pranë sobës dëgjuam Fridën tek ulëriti.

“Gjarpri!...” - tha ajo dhe erdhi pranë meje e trembur.

“Nuk të ha! Ku është?” - e pyeta unë.

“Brenda në stromë. Sapo e shpalosa ai u mblodh kulaç!” - fliste e trembur ende. U afrova me hapa të ngadalsuara dhe me një dru në dorë. Sapo e hapa stromën pashë një goxha gjarpër të mbledhur kulaç me kokën të ngritur përpjetë në qendër. E godita disa herë rresht e dërmova, por pse i thonë “përdridhesh si gjarpëri” e morra në lopatë dhe e hodha jashtë nga koteci i pulave. Fëmijët e trembur mezi u qetësuan.

“Nuk fle më tek ajo stromë!” - tha Arturi.

“Mirë të keqen mami!” - i tha Frida dhe i shtroi një dyshek të shkurtër.

“Ti Frida mos u tremb! Gjarpri u fut në stromë nga të ftohtët e madh. Bëjnë gjumin dimëror” - e sqarova unë.

“Kemi shtëpi përdhese. Kati i parë këto ka!” - vërrejti ajo.

“Nuk është i rrezikshëm gjarpri në Shqipëri. Lart në male, gjatë verës ka gjarpërinj helmatisës...” - sqarova unë... Pasi u shtroi fëmijëve stromat dhe çarçafët e bardha, me këllëfet e thara dhe të hekurosura, përgatiti darkën e thjeshtë. Akoma nuk e kishim televizorin. Në lajmet e Radio Gjirokastrës nuk u dha asnjë lajm as për heroin e mbytur as për heroin e gjallë. Unë ndeza një cigare nga marazi. “Si i mbulojnë kështu ngjarjet?” - pyeta unë Fridën.

“Mos na prish atmosferën e ngrohtë familjare!...” - ndërroi temën ajo.

Frida m'u duk e zverdhur në fytyrë. Asaj ende nuk i kishte ikur frika e gjarpërit të madh, brenda në stromën e djalit. Ajo sikur të më kuptonte tek flisja me vete, pa zë tha: “Ku të vajti mendja ta mbujoje gjarprin me gjysmën e stromës?”

“Përndryshe ai më ikte sot, por papritur nesër na hante dhe kalamajtë ose ndonje ditë tjetër,” - sqarova unë.

“E shkeli me këmbë pastaj e vrau babi!” - tha Arturi 7 vjeçar.

“Kisha një telepati se diçka do të më ndodhte,” shtoi Frida.

“Ra tek gjarpëri e keqja, të këqiat...,” - i thashë unë.

“Të kisha në rrezik të madh këto ditë..., - përfundoi

ajo.

Arturi papritur u çua nga buka dhe na solli pejsazhin e freskët me dëborë që punova në mëngjes.

“Sa bukur!” - Shprehu kënaqesinë Diana. Unë buzëqesha i kënaqur. Vendosa aty mbi dollapin e bukës që ta shijonin pejsazhin. Në mëngjes unë u nisa në punë. Rrugës shikoja njerëz të kërrusur nga të ftohtit. Binte borë. Në ora shtatë vajta me çizme ne ndërmarrje. Njerëzit për t’i shpëtuar të ftohtit kishin veshur lloj - lloj zhelesh e pallto të mëdha të vjetra. Falë rrobave ushtarake të përhapura shumë në shtetin tonë, njerëzit i vishnin rrobat e zborit, ku scili i mbante në shtëpi ose i blente lirë. Qielli ishte plot me re që lëviznin shpejt. Ato nxinin, por papritur ndonjë reze dielli i ndriçonte me rrezet e kuqëremta duke krijuar ndriçim të argjentë e të artë, pamjen fanatstike të mengjesit. Ajri i ftohtë, por shumë i pastërt. Gjirokastra edhe sot në shekullin e 21-të ka ajër të pastër dhe pse është tejmbushur me makina. Pa le më atëherë që njëqind makina kishte gjithë qarku.

Unë isha dhe jam këmbësorë sot e gjithë ditën. Kapadaive të kohës nuk u jam përulur kurrë. Punoja me durim dhe gjakftohtësi. Isha psikolog dhe kisha studiuar me kohë karakteret e njerëzve. Jeta ime ishte përqëndruar në punë, shtëpi dhe palestër. Hallet ishin në rritje. Nuk ishte jeta vetëm krijimtari. Sot në pleqëri them se kam pak kohë, por duhet shëndet dhe qetësi shpirtërore.

Atëherë duhet të punonim burrë dhe grua për të rritur fëmijët. Çuditem sot tek shikoj gra, burra, të rinj që rrinë dhe vetëm përrallisnin. Shtëpinë e kisha të hapur dhe tek ne i kishin sytë të gjithë. Prindërit vinin, vëllezërit, shokët e



miqtë. Të gjithë i kënaqja me sa mundesha. Nga goja e fëmijëve e hiqja thelën e mishit dhe nderonim, miqtë. Arsimi dhe kultura ishte qëllimi numër një i familjes sonë... Koka ime krenare dhe qëndrimi im indiferent dhe i mendueshëm ishte si rezultat i njohjes. Më rrethonin njerëz të thjeshtë, praktikë, që punonin për të jetuar. Ata më donin dhe tek unë shikonin njeriun e drejtë e të ndershëm. Isha shpresa dhe e farefisit. Kisha fituar një popullaritet të madh në saj të zotësisë sime, bëmave të guximshme dhe butësisë së shpirtit. Trimëritë ne gjirin e natyrës apo për të shpëtuar jetë njerëzish në rreziqe i kalonin mundësitë njerëzore. Këto aventura më kanë rrezikuar, sidoqë isha div dhe me fuqi Herkuli.

“Më ruat fama, kur nuk kam kredi të influencoj për një hyrje më të gjerë!” - i thashë Fridës.

“Shtëpinë na e dhanë 2 x 1, goxha hyrje, po na e rrëmbyen nga dora!” - më tha Frida, e cila m’u duk si përendesha e bukurisë dhe e dashurisë.

“Më dalldis ky fakt. Unë sakrifikoj shumë për njerëzit dhe ja si ma shpërblejnë!” - vazhdova unë arsyetimin.

“Rrjedhim nga familje të thjeshta pa asnjë influencë”, - tha Frida.

“Ç’vlen guximi dhe virtytet e tua? - tha ajo.

“Kush pyet për vullnetin e pathyeshëm, ku s’kemi asnjë mundësi për të fituar para,” - ploteësua unë.

“Ka ikur koha e trimërive dhe e forcës,” - sqarova unë.

“Bujaria dhe shpirtmadhësia nuk shpërblehet...” - shtoi ajo.

“Le të shpresojmë tek fëmijët ata duhet të mësojnë

më shumë që të bëhen më të pasur, më të ditur se ne.” -  
ëndërrova unë.

Frida m’u afrua më puthi dhe më tha: “Fytyra jote shpreh gjithçka dhe pa folur ti dukesh që je energjik dhe kërkues ndaj vetes...” Unë ia shpërbleva me një buzëqeshje gazmore plot mirësi. Frida ma pagoi me një vështrim plot me mirësi dhe respekt. Unë përgjëroheshja për të, e adhuroja; nga goja ime hiqja thelën e mishit dhe ua jepja fëmijëve dhe ajo më jepte të sajën.. Tek po hiqte pjatat, Fridës iu zbuluan paksa supet e bardha si fildish dhe flokët gështenjë i ranë përpara gjoksit. Duart e saj m’u dukën të vogla. Më pa tek isha zhytur në mendime dhe më pyeti: “Çke kështu?”

“Kryetari i Degës, vërtet nuk mund të më jepte gjësendi shpërblime por në Komitet mund të rishikonte dhe të na kthehej hyrja që na grabitën të panjohurit, kjo është arsyeja e mërzitjes sime”. psherëtiva unë.

Ajo më dëgjoi me adhurim se si unë derdha gjithë dufin e shpirtit tim dhe pa se si dridheshja nga brenga dhe padrejtësitë që na bënë ato ditë.

“Mos u mërzit, i dashur, ti do të japësh shfaqje të mëdha dhe do të plotësohet dëshira jonë për një dhomë më shumë!” - më qetësoi mua ajo krijesë, e cila e shpërbleu me besnikëri dashurinë time.

Papritur Frida më pyeti: “Në ujë je ndodhur ngushtë shumë herë... Po në tokë ke ndonjë rast? A ke shëmbuj heronjsh e trimash?”

“Posi, në Përmet kam provuar rreziqe të mëdha!...” - fillova unë dhe ndërkohë, çava disa kokra arrë, i qëroja dhe ua futja në gojë fëmijëve si dallëndyshja zogjve të vet...

“Frida. Frida e bëre pyetjen dhe ike të lash enët? Ta-

-llesh apo do të rrih të më dëgjosh?”

“Erdha, erdha... Më fal!...” - u shfajësua ajo.

“Meqë isha veteriner i qytetit pergjigjesha dhe për fshatrat përreth, nisa të tregoja unë:

“Nisu në Goriçan, Raban, Sevran” - jepte urdhër kryetari. “Shumë afër janë...” - thoshte kryetari apo shefi i bujqësisë, Thoma Thomai. Unë nisesha, por mezi gjeja makinë nga Përmeti për në fermën e Piskovës. Rrugët ishin të pashtruara. Xhadeja ishte rruga më 1962-1963, e më pas, në Përmet, Korçë, Gjirokastër, Berat etjera, rrugët kanë qenë vetëm xhade, të pashtruara!

Nga Piskova ngjitesha përpjetë zonës së Pagrisë rrugë e zonës kodrinore që të çonte në zonat më të larta, malore. Në të djathtë shtriheshin pyjet që të çonin në Hotovë, Kosovë e në të majtë zonat e thepisura të Odriçanit, Rabanit, Sevranit. Kam ecur e jam ngjitur në buzë të përrenjëve dhe rrëpirave të pjerta prej shtufi të lagura nga shirat. Kam zbritur në buzë greminash dhe honesh vdekjeprurëse. Kam ecur mbi shkëmbenj dhe nën shkëmbinj të llahtarshëm, të cilët me të ngritur kokën lartë të duket sikur do të bien mbi kokë. Kam ecur mbi shkëmbinj nën rrezën e ngushtë të këtyre shkëmbinjve ne një rrugicë dhiarc një pëllëmbë të ngushtë në të cilin rridhnin rrekerë prej argjili ishte bërë gati për patinazh. Duke ecur në këtë rrugicë një pëllëmbë të gjerë, të lagur, kujtoja ecjen mbi tel, i cili më ngjante si lule. Aty buzë greminës nuk guxoja dot të hidhja vështrimin nga e djathta se gremina ishte e tmerrëshme. Që andej lart shikoja ku ndodhesha unë, dhinë ngjanin si mizat e zeza, ndërsa delet si fasule të bardha...

Ajo ishte lodhje që dersija në palcën e dimrit dhe me

gabimin më të vogël jeta humbet. Në të majtë hidhja dorën, po ku të kapesha? Aty këtu shikoje xana apo bimë xhufkore, të cilave nuk mund t' u besojë jetën me ato rrënjë të ngulura në sipërfaqe të dheut.

“Bobo ç’ke hequr! Ti më tregojë, por fare shkurt, kur vije nga fshatrat,” - tha Frida: “Gruaja është qenie delikate nuk doja të të shqetësoja... Unë të kam ruajtur me kujdes dhe të kam lënë të lirë ty, ndaj të kam edhe sot si lule!” Gruaja është një lule, që të lulëzoj do ushqim, ngrohtësi, vaditje, liri, qetësi”

Fëmijët më dëgjonin me vëmendje dhe më shikonin drejt në sy. Duke mos patur televizor, me biseda i edukonim fëmijët dhe vetveten.

“Të tilla udhëtime të rralla i ke patur,” - tha Frida.

“Jo fort rrallë, ndofta 20 herë në vit, po e po,” - sqarova unë.

- Janë të nevojshme. E ndihmojnë shëndetin e njeriut. këto janë udhëtime alpinistike. Organizmi i njeriut lodhet, trupi djersin, zemra rreh me shpejtësi. Shtohet qarkullimi i gjakut, rritet numri i frymëmarrjes. Bëhet mirë djegja e lëndëve, shtohet metabolizmi dhe qelizat marrin më shumë oksigjen. Në gjendje normale, qetësic mushkëritë thithin vetëm një të nëntën e kapacitetit me oksigjen, kurse gjatë marshimeve te tilla mushkëritë mbushen nga frymëmarrjet e thella.”

“E di kam bërë Filozofi në Institutin e Fiskulturës “Vojo Kushi” - më tha Frida dhe pastaj vijoi: “Muskujt djegin me shumë glukozë”.

“Ja përgjigju. Kush djeg më shumë glukozë truri apo muskujt?”

“Nuk e di !...” - m’u përgjigj ajo.

“Truri 80% të energjisë e merr nga glukozja, ndërsa muskujt 60% - sqarova unë.

“Ja ku të pyes. Në një centimetër katror, muskujt kanë 30 - 80 kapilarë enë të vogla gjaku që shpien gjakun e pastër me oksigjen dhe tërheqin gazin karbonik. Po gjatë një marshimi të sforcuar sa kapilarë aktivizohen?”

- “Ja ku po ta them me saktësi të madhe” - m’u përgjigj ajo me sinjeritet. “Në të njëjtën sipërfaqe, aktivizohen 3 mijë kapilarë ose 40-100 herë më shumë. Në çdo 100 cm kub muskul ekzistojnë 0,05 cm kub kapilarë volum. Pas një marshimi ose pune intensive, në çdo 1000 cm kub aktivizohen 15 cm kub volum kapilarësh. Pra numri i tyre rritet 300 herë. Nga kjo del që muskujt e stërvitur kanë një herë e gjysëm më shumë kapilarë se sa muskujt e pastërvitur. Gjatë ushtrimeve fizike në muskujt lindin dhe formohen kapilarë të rinj. Me ta shtohen sasitë e substancave ushqimore që shpie gjaku plus oksigjenin.”

Më habite me përgjigjen e saktë. Të lumtë Frida

“Tani të kuptova pse i merr fëmijët me vrap në Virua dhe ju mëson cirkun dhe peshngritjen!” - më tha ajo.

“Unë kam parë pyje të virgjërta, kur udhëtoj në fshatrat malore. Hotova ka pyje bredhi e pishe. Rabani e Sevrani ka pyje dushku ku rritet derri i egër, lepuri, dhelpra dhe ujku. Në ato drurë të egër ngjiten lart hardhi të trasha, të cilat kacaviren në ato pyje dhe siç janë të ushqyera mirë më atë humusin e zi të pyllit, japin një prodhim maksimal e rrushi Korith është një rush i kuq i formuar me kopane të mëdha. Çdo kopan peshon 4 kg sejcili. Ato hardhi e vreshta i kanë mbjellë të parët e atyre banorëve të bekuar

të Përmetit. Në mëngjes kokrat dhe kopanët i lagte vesa e mëngjesit. Ah sa çlodhem unë nga klorofila,” - shtova unë.

“Natyra më sjell kënaqësi për syrin dhe më çlodh trurin!” - përkufizoi Frida.

“Natyra di se ç'bën. Harmonizon qëniet e saj, njerëzit, kafshët, bimët me natyrën, sendet, malet, fushat, detet.”

“Lum si ti që ke shfrytëzuar natyrën!” - më tha Frida.

Në Përmet kam parë bukuri të veçanta. Në hije të thella me pemë, drurë, shpella; kam parë burime të çuditshme me ujë të kristaltë akull, kur natyra digjet gjatë verës së nxehtë. Edhe fshatarët e atyre anëve kanë gdhendur gure prej të cilëve rrjedh ujë i freskët në ulluqet e tyre plot myshk dhe alga të gjelbërta, të errëta.”

“E kam dëgjuar proverbin: “O Përmet, o xhenet, bukë pak dhe ujë det!” - tha Frida.

Me ato burime tërë myshqe e alga që lëvizin bashkë me ujin e ftohtë që derdhet papushin nuk ngopesh kurrë së piri ujë...

## Permbajtja

1. Faqe Ditari.....	5
2. Zjarr në akull .....	18
3. Zhgënjim dhe ngadhënjim .....	44
4. Epilog .....	57

**Libri u shtyp në shtypshkronjën “Manka”  
Janar 2002**



# Shpirti vetmohues i autorit



Foto 1, kercim fantastik  
me salto në  
Vjosë nga 10 m l, autorit, 1962